

STRUKTURA E RAPORTIT

1	FUNKSIONI I MBIKËQYRJES	2
2	ZHVILLIMET KRYESORE	2
3	EKZAMINIMET NË VEND	6
4	KUADRI RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK	8
5	LICENCIMI.....	12
6	ECURIA E RREZIQEVE NË SISTEMIN BANKAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA	16
6.1	Zhvillimet kryesore në ecurinë e sistemit bankar shqiptar.....	16
6.2	Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës	17
6.3	Struktura e sistemit bankar	17
6.3.1	Aktivitet dhe pasivitet, struktura e tyre	17
6.3.2	Përqendrimi	20
6.4	Administrimi i rreziqeve në veprimtarinë bankare.....	20
6.4.1	Rreziku i kredisë	20
6.4.2	Rreziku i likuiditetit	30
6.4.3	Rreziqet e tregut.....	33
6.4.4	Rreziku operacional	34
6.4.5	Rreziku reputacional.....	35
6.4.6	Përfitueshmëria	45
6.4.7	Mjaftueshmëria e kapitalit	47
6.5	Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit.....	50
6.5.1	Subjektet financiare jobanka.....	50
6.5.2	Institucionet e pagesave dhe të parasë elektronike	55
6.5.3	Unionet financiare dhe shoqëritë e kursim-kreditit.....	57
6.6	Regjistri i Kredive.....	59
	ANEKSE.....	61

1 FUNKSIONI I MBIKËQYRJES

Funksioni mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë (BSH) ka si objektiv kryesor identifikimin e hershëm të rreziqeve që shoqërojnë veprimtarinë e institucioneve financiare, si: rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku operacional, rreziku i normës së interesit, rreziku i kapitalit dhe i përfitueshmërisë, rreziku reputacional, si dhe rreziku i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizmit, por jo vetëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe efektiviteti i qeverisjes korporative përbëjnë një fokus të veçantë të procesit mbikëqyrës, si faktorë të rëndësishëm të zbutjes së rreziqeve në të gjithë sferën e veprimtarisë së bankave në veçanti, por edhe të subjekteve të tjera jobanka, të cilat licencohen nga BSH-ja. Veprimi në kohën e duhur, marrja e masave rregulluese efektive nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme, si edhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre, mbeten hallka të rëndësishme për finalizimin me sukses të qëllimit fundor që synon ruajtjen e shëndetit të subjekteve financiare.

2 ZHVILLIMET KRYESORE

Zhvillimet Strukturore

Viti 2025 shënoi zhvillime pozitive, veçanërisht në përmirësimin e cilësisë së portofolit të kredisë së sistemit bankar. Në fund të vitit, treguesi përkatës arriti vlerën 3.8%, niveli më i ulët historik që prej vitit 2008. Gjatë vitit të kaluar, ky tregues u ul me 0.37 pikë përqindjeje, zhvillim ky që eci përkrah me rritjen e kënaqshme të portofolit të kredisë me 13.45% në terma bruto. Nivelet e kapitalizimit të sistemit bankar mbetën të larta dhe shënuan rritje përgjatë vitit. Në dhjetor të vitit 2025, u raportua një tregues i mjaftueshmërisë së kapitalit në vlerën 20.36%, përkundrejt vlerës prej 19.52% në fund të vitit të kaluar. Likuiditeti paraqitet në nivele ndjeshëm mbi limitet rregullatore, me tregues si ai i mbulimit me likuiditet, raporti neto i financimit të qëndrueshëm dhe treguesi i likuiditetit përkatësisht në vlerat prej 273.3% (100% minimumi rregullator), 198% (100% minimumi rregullator) dhe 43.3% (20% minimumi rregullator).

Në fund të vitit 2025, në sistemin bankar vijojnë të operojnë 11 banka, një numër i konsoliduar ky që prej fundit të vitit 2022. Megjithatë, panorama e sistemit bankar pritet të pësojë ndryshime në kushtet kur gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka dhënë miratimin paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" dhe të bankës "JetBank".

Mbrojtja konsumatore

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorit janë forcuar kërkesat për transparencë në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, veçanërisht në drejtim të informimit të klientëve mbi kushtet e punës të ofruara nga bankat, si normat e interesit, kostot totale, komisionet dhe kushtet kontraktuale. Subjektet janë të orientuara drejt përdorimit të një gjuhe më të qartë dhe të krahasueshme, në mënyrë që konsumatorët të marrin vendime të mirinformuara.

Në të njëjtin kuadër, vijon të evidentohet rënia e normës efektive të interesit si rezultat i masave të marra për vendosjen e limitit maksimal të kësaj norme për ekspozimet me natyrë konsumatore. Si rezultat i kësaj ndërhyrjeje, kjo normë paraqitet në nivelin prej rreth 62%, përkundrejt nivelit 95% që ishte në fund të vitit 2024. Në këtë rënie ka ndikuar edhe ndryshimi i metodologjisë së llogaritjes, duke u bazuar vetëm në mesataren e tregut dhe duke eliminuar shtesën prej 33% të parashikuar në përcaktimet e mëparshme rregullative.

Kontributi në procesin e integritetit evropian

Në kuadër të procesit të integritetit në strukturat evropiane është bërë një punë e zgjeruar për rishikimin dhe hartimin e kuadrit ligjor e rregullativ që synon përafrimin e plotë me kërkesat e *acquis* të Bashkimit Evropian (BE), por edhe për adresimin e problematikave të ndeshura në subjektet e mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve ka qenë puna për hartimin e ligjit të ri për bankat në Republikën e Shqipërisë, i cili do të përafrojë plotësisht kërkesat e Direktivës 2013/36/EU (CRD IV/V/VI) dhe disa dispozita relevante të akteve të tjera të BE-së, si rregullores 575/2013/EU (CRR) dhe Direktivës 2001/24/EC. Po kështu, gjatë vitit të kaluar ka filluar puna për hartimin e ndryshimeve të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e Direktivës së Shërbimeve të Pagesave të BE-së 2015/2366/EU (PSD2) dhe disa dispozitave të Direktivës së Parasë Elektronike 2009/110/EC (EMD2).

Vlerësimi i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ

Në kuadër të vlerësimit të përshtatshmërisë së kuadrit ligjor e rregullativ, si dhe praktikave mbikëqyrëse me standardet më të përparuara evropiane, gjatë vitit 2025, vijoi procesi i vlerësimit të ekuivalencës. Nëpërmjet tij, Autoriteti Bankar Evropian (EBA) vlerëson praktikat mbikëqyrëse sipas një metodologjie të përcaktuar prej tij. Aktualisht, Banka e Shqipërisë është në ndjekje të hapave dhe orientimeve të EBA-s lidhur me proceset e parashikuara prej saj.

Bashkëpunimi me autoritetet ndërkombëtare

Bashkëpunimi me autoritetet homologe në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse vijoi edhe këtë vit. Këto struktura bashkëpunimi, të ngritura prej disa vitesh tashmë, u mundësojnë mbikëqyrësve të vendeve të ndryshme të mbledhen për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat në vendet e tyre, në lidhje me një institucion të caktuar bankar. Ndërkohë, gjatë këtij viti, Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë rregullisht në këto takime, veçanërisht për grupin e Bankës Raiffeisen. Mbledhja e Kolegjit të Mbikëqyrësve është organizuar në Shqipëri në ambientet e Bankës së Shqipërisë¹, me pjesëmarrjen e mbikëqyrësve nga disa vende të Evropës, ku grupi Raiffeisen është i pranishëm.

Rishikimi i kuadrit mbikëqyrës lidhur me digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike

Siguria e informacionit përbën një element kritik për garantimin e stabilitetit operacional, besueshmërisë dhe pajtueshmërisë rregullatore të sektorit bankar. Në këtë kontekst, me qëllim përmirësimin e masave mbrojtëse të sektorit bankar ndaj rrezikut kibernetik dhe forcimin e vigjilencës mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Zyrën e Asistencës Teknike të Thesarit Amerikan, hartoi dokumentin “Udhërrëfyesi i Vetëvlerësimit të Rrezikut Kibernetik”, në përputhje me standardin ISO/IEC 27002. Ky dokument është objekt zbatimi nga bankat dhe rezultatet e prodhuara nga ky vlerësim janë përdorur nga Banka e Shqipërisë për të hartuar një vlerësim horizontal dhe të unifikuar, mbi masën e maturitetit të proceseve/kontrolleve që lidhen me rrezikun kibernetik dhe adresimin e problematikave që burojnë prej tij.

Paralelisht, është hartuar projektregullorja “Për qëndrueshmërinë operationale digjitale”, në përputhje me kërkesat e rregullores së BE-së 2022/2554/EU (DORA), ku janë përfshirë edhe standardet teknike plotësuese të parashikuara në disa rregullore të deleguara të Bashkimit Evropian. Nëpërmjet këtyre kërkesave, bankave do t’iu duhet të përshtatin sistemet, strukturat dhe procedurat e brendshme në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë operationale digjitale dhe administrimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe të rrezikut kibernetik.

Financa e gjelbër

Në kuadrin e financës së gjelbër dhe strategjisë së hartuar për përfshirjen e saj në proceset mbikëqyrëse, në vitin 2025, bankat kanë raportuar formularin e vetëvlerësimit të

¹ [*College of Supervisors Meeting organized by the European Central Bank \(ECB\); hosted by the Bank of Albania*](#)

përputhshmërisë së kuadrit të proceseve të tyre të brendshme të administrimit të rrezikut me pritshmëritë mbikëqyrëse, sipas përcaktimeve të udhëzuesit të publikuar një vit më herët.

Për secilën bankë, bazuar në këto raportime, është bërë një vlerësim i detajuar i nivelit të përputhshmërisë dhe cilësisë së vetëvlerësimit, si dhe është adresuar plotësimi i mangësive të konstatuara apo ndryshimi i planeve për përmbushjen e kërkesave të udhëzuesit, veçanërisht në drejtim të shkurtimit të kohës së vënies së tyre në zbatim.

Po kështu, gjatë vitit të kaluar, është punuar për hartimin e objektivave të strategjisë së ardhshme mbikëqyrëse për rritjen e përfshirjes së financave të gjelbëra në proceset mbikëqyrëse dhe në vlerësimet e mëtejshme të bankave.

Ndjekja e rekomandimeve të MONEYVAL-it

Gjatë vitit 2025, vijoi puna për plotësimin e pyetësorëve të MONEYVAL-it, si dhe për hartimin e disa ndryshimeve rregullative që synojnë plotësimin e rekomandimeve të ekspertëve, të dala nga raundi i mëparshëm i vlerësimit të Shqipërisë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave. Plotësimi i pyetësorit teknik dhe atij të efektivitetit do t'i paraprijë vlerësimit (Raundit të 6-të) të Shqipërisë në këtë fushë, që konsiderohet si një nga proceset me rëndësi të veçantë për vendin.

Përmirësimet në kuadrin mbikëqyrës, përfshirë këtu forcimin e kushteve dhe kriterëve të licencimit për zyrat e këmbimit valutor, shtimin e kontrolleve dhe rritjen e cilësisë së raportimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht me Autoritetin e Inteligjencës Financiare (AIF), kanë qenë ndër prioritetet kryesore të Bankës së Shqipërisë. Këto masa janë ndërmarrë në përputhje me rekomandimet e MONEYVAL-it dhe i paraprijnë vlerësimit të tyre të radhës, i cili është aktualisht në proces shqyrtimi.

3 EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2025 janë kryer gjithsej 12 ekzaminime në vend, nga të cilat 3 ekzaminime të plota dhe 1 ekzaminim i pjesshëm në banka, 3 ekzaminime të plota dhe 1 ekzaminim i pjesshëm në subjekte jobanka, 2 ekzaminime të plota pranë institucioneve të parashë elektronike dhe 2 ekzaminime të pjesshme në shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK).

Tabelë 1. Numri i ekzaminimeve sipas tematikës për vitin 2025

Inspektim e të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Këmbimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfitueshmëria	Kapitali
2023	8	8	8	8	4	8	7	7	61*	8	8
2024	11	10	9	11	3	11	8	8	48**	11	11
2025	3	11	12	12	3	11	8	9	35***	11	11

* Në vitin 2023 janë kryer ekzaminime në 50 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional, ndërkohë që 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

** Në vitin 2024 janë kryer ekzaminime në 37 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional ndërkohë që 11 ekzaminime për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

*** Në vitin 2025 janë kryer ekzaminime në 26 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional ndërkohë që 9 ekzaminime për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

Gjatë vitit 2025 janë ekzaminuar dy banka sistemike dhe dy banka josistemike. Ekzaminimet e plota kanë mbuluar të gjitha aspektet e veprimtarisë së bankave, ndërkohë që ekzaminimi i pjesshëm është fokusuar në menaxhimin e rrezikut të portofolit të kredisë, cilësinë e aktiveve të tjera në bilancin e bankës dhe rrezikun e likuiditetit. Vëmendje e veçantë në ekzaminime i është kushtuar edhe marrëdhënieve me palët e lidhura me bankën dhe zbatimit të parimeve të kujdesit nga ana e tyre (bankave) për zhvillimin e këtyre marrëdhënieve në kushte të ngjashme me klientët e zakonshëm.

Në kuadër të zhvillimeve të vazhdueshme në procesin e digjitalizimit dhe të ndërthurjes së sistemeve e teknologjive të ndryshme të përdorura gjatë aktivitetit bankar është evidentuar nevoja për të balancuar sa më mirë nivelin e shpenzimeve të nevojshme kapitale dhe operacionale me objektivat dhe vëllimet e synuara të biznesit. Kjo synon të sigurojë arritjen e niveleve të pranueshme të aktivitetit, që justifikojnë investimet e kryera dhe nivelin e rrezikut operacional e kibernetik të marrë përsipër.

Në përfundim të proceseve të ekzaminimit janë lënë një sërë rekomandimesh dhe janë marrë masa administrative, si gjopa dhe vërejtje për administratorët apo edhe kufizime të veprimtarive të caktuara të cilat janë konsideruar të rëndësishme për një qasje prudenciale në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë së shëndetshme bankare.

Edhe gjatë vitit 2025, ekzaminimet e subjekteve të tjera, përveç bankave, janë orientuar drejt mbulimit të kategorive të ndryshme të veprimtarisë, në përputhje me pjesën e tregut që zotërojnë sipas aktivitetit përkatës (subjekte jobanka, shoqëri kursim-krediti dhe institucione të parasë elektronike).

Fokusi kryesor i ekzaminimeve ka qenë vlerësimi i modelit të biznesit, sistemeve të qeverisjes, rrezikut të kredisë, rreziqeve të tregut dhe atyre operacionale, saktësisë së raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparencës me klientët dhe rrezikut të pastrimit të parave. Në këtë kontekst, sa i përket subjekteve të ekzaminuara për herë të parë, një vëmendje e veçantë i është kushtuar realizimit të parashikimeve që kanë shoqëruar aplikimin për licencë dhe qëndrueshmërisë së modelit të biznesit mbi të cilin mbështetet veprimtaria e tyre.

Në përgjithësi aktiviteti i këtyre subjekteve gjeneron të ardhura të qëndrueshme, të cilat kanë mbështetur kapitalin në vazhdimësi. Megjithatë, përmirësime të mëtejshme duhen realizuar kryesisht në drejtim të cilësisë së qeverisjes, plotësimit të kuadrit të brendshëm organizativ dhe rregullator, si dhe mbështetjes me sisteme të automatizuara, teknologji etj. Të gjitha këto elemente duhet të zhvillohen dhe plotësohen në përputhje me rritjen e aktivitetit.

Për shkeljet dhe mangësitë e evidentuara, Banka e Shqipërisë ka marrë masat përkatëse mbikëqyrëse. Më konkretisht, janë dhënë rekomandime me afate konkrete për adresimin e dobësive të evidentuara, i janë vendosur gjopa dy institucioneve të parasë elektronike, si dhe është caktuar masa e pezullimit të aktivitetit për një subjekt jobankë dhe revokimi i licencave për një SHKK, dy subjekte jobanka dhe një institucion pagese.

Ndërkohë, gjatë këtij viti janë kryer inspektime në vend për 26 zyra të këmbimit valutor (ZKV), ku është përfshirë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë. Ndërkohë që për një ZKV është kryer një inspektim i përbashkët me AIF-në. Për ZKV-të, vlen të përmendet se gjatë periudhës shkurt – mars 2025 është zhvilluar fushata e ndjekjes së përmbushjes së detyrimit për raportim në Bankën e Shqipërisë. Si rezultat i këtij procesi, janë marrë 200 masa administrative për mosraportimin në Bankën e Shqipërisë dhe në disa raste u është hequr edhe licenca.

4 KUADRI RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë vijoi punën për hartimin dhe rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, me synim përafrimin e tij me legjislacionin e Bashkimit Evropian, forcimin e kërkesave mbikëqyrëse dhe adresimin e çështjeve të evidentuara gjatë mbikëqyrjes së bankave dhe institucioneve të tjera financiare të licencuara prej saj.

Departamenti i Mbikëqyrjes është angazhuar maksimalisht gjatë vitit 2025 në plotësimin e Pyetësorëve të Ekuivalencës së Autoritetit Bankar Evropian (ABE) për fazat 1 dhe 2 (*Step 1 and 2*). Faza 1 është kaluar me sukses dhe pritët nga ABE-ja vlerësimi për fazën 2. Një angazhim tjetër i rëndësishëm ka qenë edhe plotësimi i informacioneve për Pyetësorin Teknik dhe Pyetësorin e Efektivitetit, në kuadër të raundit të 6-të të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL.

Departamenti i Mbikëqyrjes ka kontribuar edhe në procesin e integritit evropian, nëpërmjet përfaqësimit të Bankës së Shqipërisë në Kapituj të caktuar dhe përgatitjes së informacioneve të kërkuara.

Në kuadër të harmonizimit të kuadrit ligjor me *acquis* e Bashkimit Evropian si pjesë e procesit të anëtarësimit, ka vijuar puna për hartimin e ligjit të ri “Mbi ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre”, duke synuar përafrimin me Direktivën 2013/36/BE dhe ndryshimet pasuese të saj, si dhe me disa akte të tjera relevante të BE-së.

Gjithashtu, ka nisur puna për rishikimin e ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, me qëllim përafrimin e plotë me Direktivën (BE) 2015/2366 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”, si dhe me Direktivën (KE) 2009/110 “Mbi krijimin, ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike”, për të siguruar plotësimin e disa prej angazhimeve të marra në kuadër të Kapitullit 4 të integritit.

Përfaqësues nga Departamenti i Mbikëqyrjes kanë kontribuar në cilësinë e anëtarëve të grupit të përbashkët të punës midis Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në hartimin e projekt-ligjit të ri “Për mbikëqyrjen shpesh të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimeve dhe shoqërive komisionere, pjesë e konglomerateve financiare”, në përputhje me Direktivën 2002/87/EC.

Për sa i përket kuadrit rregullator, vlen të përmenden ndryshimet e miratuara në lidhje me përmirësimin e kërkesave ekzistuese për mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e transparencës ndaj tyre, në përgjigje të dinamikave të hasura në treg, në lidhje me kontratat e kredisë konsumatore, si dhe për ndalimin e praktikave abuzive.

Në vijim të përmirësimit të praktikave mbikëqyrëse dhe në përputhje me rekomandimet e dhëna gjatë procesit të vlerësimit të MONEYVAL nga raundi i mëparshëm i vlerësimit të Shqipërisë, gjatë vitit 2025, u miratuan edhe disa ndryshime në kuadrin rregullator të zyrave të këmbimit valutor, me fokus forcimin e procedurave të licencimit dhe mbikëqyrjes, si dhe përmirësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Paralelisht, ka vijuar puna për rishikimin e kuadrit rregullator licencues për bankat, subjektet financiare jobanka, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike dhe shoqërive të kursim-kreditit².

Në këtë kontekst, u miratuan disa ndryshime, të cilat synonin lehtësim në trajtimin e ekspozimeve të bankave ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, nëpërmjet rishikimit të disa masave prudenciale, përfshirë këtu rishikimin e kuadrit rregullator mbi mjaftueshmërinë e kapitalit, ekspozimet e mëdha dhe mbikëqyrjen e konsoliduar.

Njëkohësisht, gjatë vitit 2025, vijoi puna për hartimin e projekt-rregullores “Për qëndrueshmërinë operationale digjitale”, në përputhje me rregulloren e BE-së 2022/2554 (DORA), ku u përfshinë edhe disa standarde teknike plotësuese të DORA-s.

Në mënyrë më të detajuar, zhvillimet në kuadrin rregullativ gjatë vitit 2025, paraqiten në vijim.

I. Në kuadër të përmirësimit dhe forcimit të kërkesave për mbrojtjen e konsumatorit dhe rritjen e transparencës ndaj klientëve u realizuan:

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare” (miratuar me vendimin nr. 10, datë 5.2.2025, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Ndryshimet në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, përfshijnë disa kërkesa të shtuara, në kuadër të reduktimit të kostove të ngarkuara konsumatorit në kontratat e kredisë konsumatore me këste, kryesisht në vlera të vogla (në fashën 0-200.000 lekë). Nëpërmjet këtyre ndryshimeve realizohet një rishikim i metodologjisë së Bankës së Shqipërisë për përllogaritjen e NEI-t maksimal për këtë kategori të kredisë konsumatore, si dhe vendosja e kërkesës për të mos lejuar shpërndarjen e komisioneve të aplikuara nga subjektet në momentin e dhënies së kredisë, përgjatë jetëgjatësisë së kredisë apo përfshirjen e tyre si pjesë e kësteve të kredisë. Përmes ndryshimeve të miratuara në rregullore u bë gjithashtu i mundur qartësimi i elementeve përbërëse të

² Këto ndryshime u miratuan në fillim të vitit 2026 nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

këstit të një kredie, ku në çdo rast si pjesë e këstit do të konsiderohet vetëm kryegjëja dhe interesi.

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare” (miratuar me vendimin nr. 11, datë 5.2.2025, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Këto ndryshime konsistojnë në përcaktimin e disa kërkesave të shtuara për rritjen e transparencës ndaj konsumatorëve gjatë fazës së reklamimit të produkteve dhe shërbimeve, nëpërmjet standardizimit të kërkesave për subjektet dhe diferencimit sipas tipologjisë së produktit apo shërbimit të reklamuar. Ato përcaktojnë gjithashtu disa kërkesa minimale për elementet që duhet të përmbajë reklama, format e komunikimit me konsumatorët, si dhe masat që mund të ndërmerren Banka e Shqipërisë për ndalimin ose korrigjimin e reklamave, në rast të konstatimit të shkeljeve të rregullores.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve rregullatore, u prezantuan disa kërkesa të reja mbi informacionin standard që duhet të përmbajnë reklamat i) për kredinë konsumatore, në përputhje me kërkesat për reklamat dhe marketingun e kredisë konsumatore, të parashikuara në Direktivën e re të Kredisë Konsumatore 2023/2225/BE; ii) për kredinë hipotekare, në përputhje me kërkesat për reklamat dhe marketingun e kredisë hipotekare për konsumatorët, të parashikuara në Direktivën e Kredisë Hipotekare 2014/17/BE; iii) për depozitat që bankat duhet t’u paraqesin konsumatorëve.

Me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve, ndryshimet rregullatore shtuan edhe disa kërkesa për ndalimin e përdorimit të disa shprehjeve në reklama, të cilat mund të krijojnë perceptime të gabuara te konsumatorët, me përjashtim të rasteve kur këto shprehje bazohen në fakte që provohen si të vërteta.

- II. Në kuadër të përmirësimit dhe forcimit të kërkesave licencuese dhe mbikëqyrëse të zyrave të këmbimit valutor, si dhe në kuadër të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për këto subjekte, u realizuan këto ndryshime rregullative:**

- **Miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” (miratuar me vendimin nr. 42, datë 3.9.2025, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

Ndryshimet në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” konsistojnë në përmirësimin e procesit të licencimit dhe të mbikëqyrjes së këtyre subjekteve, duke adresuar kërkesat që lidhen si me aspektet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ashtu edhe me nevojën e forcimit të rregullave të hyrjes në treg të subjekteve që janë financiarisht të

qëndrueshme dhe me integritet. Paralelisht, ndryshimet rregullative bëjnë një përcaktim të qartë të konceptit “reputacion i mirë” dhe “pronar përfitues”, si dhe parashikojnë një rritje të nivelit të kapitalit fillestar të kërkuar për licencimin e zyrave të këmbimit valutor, ndryshime në strukturën e pronësisë, vendosjen e disa limiteve për vlerat monetare në para fizike (*cash*), të cilat mund të mbahen nga subjekti në arkë mbi baza ditore, si dhe për vlerën maksimale të transaksioneve në para fizike (*cash*), në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën etj.


III. Zhvillime të tjera rregullative

- **Miratimi i ndryshimeve të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, rregullores “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” dhe rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar” (miratuar përkatësisht me vendimin nr. 31, nr. 32 dhe nr. 33, datë 2.7.2025, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë):** Ndryshimet e miratuara konsistojnë në lehtësimin e peshave të rrezikut për llogaritjen e kërkesave për kapital në llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (në nivel individual dhe të konsoliduar) dhe reduktimin e vlerës së ekspozimit për ekspozimet maksimale të lejueshme, për ekspozimet e sektorit bankar ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, të cilat përmbushin disa kriterë specifike dhe vlerësohen me rrezik të reduktuar.

5 LICENCIMI

Në fund të vitit 2025, struktura e sistemit bankar dhe financiar përbëhet nga 11 banka, 36 subjekte financiare jobanka (përfshirë këtu edhe 6 institucionet financiare të mikrokredisë), institucione të pagesave dhe institucione të parasë elektronike, 592 zyra të këmbimit valutor, 15 shoqëri të kursim-kreditit dhe 1 union të shoqërive të kursim-kreditit.

Grafik 1. Struktura e sektorit bankar/financiar dhe pronësia



Banka e Shqipërisë, bazuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ligjin “Për shërbimet e pagesave” dhe ligjin “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, ka autoritetin për të licencuar dhe mbikëqyrur bankat, subjektet financiare jobanka, institucionet e pagesave, institucionet e parasë elektronike, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, si dhe zyrat e këmbimit valutor.

1. *Për bankat*

Gjatë vitit 2025, në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj licencues, Banka e Shqipërisë ka marrë vendime që lidhen me:

- a) miratimin paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Türkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania”;
- b) miratimin paraprak për licencimin e bankës “Banka Jet” sh.a. (banka digjitale);
- c) miratimin për riorganizimin e bankës, nëpërmjet bashkimit me përthithje (subjekti financiar jobankë NOA sh.a. përthithet nga Banka Amerikane e Investimeve);
- d) miratimin për transferimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrolluese)/ të tërthortë të 1 banke;
- e) miratime për 32 administratorë të bankave, ndër të cilët, sipas pozicioneve, renditen përkatësisht 14 anëtarë të këshillave drejtues, 9 anëtarë të komiteteve të kontrollit dhe 9 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm të bankave;
- f) miratimin e zgjerimit të rrjetit të bankave me 8 degë të reja, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- g) miratime të ndryshimeve në statutet e bankave dhe për emërimet/riemërimet e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të fundvitit 2025 të të gjitha bankave;
- h) miratime për emetim dhe shlyerje të borxhit të varur nga bankat.

2. *Për subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike*

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë për subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë, institucionet e parasë elektronike dhe institucionet e pagesave, gjatë vitit 2025, konsiston në:

- a) licencimin e shoqërisë “Happy Pay” sh.a. për të vepruar si institucion i parasë elektronike;
- b) miratimet paraprake për emërimin/ riemërimin e 10 administratorëve, 2 kryetarëve të këshillave mbikëqyrës dhe 2 kryetarëve të komiteteve të kontrollit;
- c) miratimet për transferimin e pjesëmarrjes influencuese (kontrolluese) të kapitalit të dy subjekteve financiare dhe të dy institucioneve të parasë elektronike;

- d) miratimin për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë të një institucioni të parasë elektronike;
- e) miratimet/moskundërshtimet për emërimet/riemërimet e ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të fundvitit 2025 të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike;

3. Për shoqëritë e kursim–kreditit dhe unionet e tyre

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues për shoqëritë e kursim–kreditit (SHKK) dhe unionet e shoqërive të kursim–kreditit, gjatë vitit 2025, konsiston në dhënien e miratimit për riorganizimin juridik të një SHKK-je, bashkimin me përthithje, dhënien e miratimit për emërimin/riemërimin e 5 administratorëve të SHKK-ve, 4 kryetarëve të këshillave drejtues si dhe 4 kryetarëve të komiteteve të kontrollit.

4. Për zyrat e këmbimit valutor

Vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë, në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj licencues për zyrat e këmbimit valutor, konsiston në:


- a) licencimin e 33 zyrave të reja të këmbimit valutor; dhe
- b) revokimin e licencës së 83 zyrave të këmbimit valutor, si masë mbikëqyrëse dhe për shkak të ndërprerjes së veprimtarisë.

5. Të tjera

Në fund të vitit 2025, bankat ushtrojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet 408 degëve/agjencive, të shtrira brenda territorit të vendit.

Në grafikun në vijim, gjendet informacioni mbi numrin e degëve të bankave dhe tendencën e ndryshimit të tyre në vite.


Grafik 2. Ecuria e numrit të degëve/agjencive të bankave në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja gjeografike e degëve/agjencive bankare përfshin pothuajse të gjithë territorin e vendit. Përqendrimi më i madh i degëve dhe agjencive bankare është në Tiranë (45.59%), ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i lartë (32.16%). Po kështu, evidentohet se shpërndarja e degëve dhe agjencive bankare, sipas rajoneve, është në përpjesëtim me numrin e popullsisë.


Grafik 3. Shpërndarja gjeografike e popullsisë banuese dhe rrjetit të degëve/agjencive të bankave, sipas qarqeve, në vitin 2025 (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.

Gjatë vitit 2025, vijuan aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor. Në fund të këtij viti, kjo veprimtari ushtrohet nga 592 zyra të këmbimit valutor. Gjatë vitit u dhanë 33 licenca të reja të zyrave të këmbimit valutor, si dhe u revokuan 83 licenca.

Grafik 4. Ecuria e numrit të zyrave të këmbimit valutor të licencuara në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në zbatim të kërkesave të kuadrit rregullativ në fuqi, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike mund të ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe/ose të shpërndarjes dhe të ripagimit të fondeve. Në rastin e institucioneve të parasë elektronike, këtë veprimtari mund ta kryejnë edhe nëpërmjet agentëve, numri i të cilëve, në fund të vitit 2025, ka shënuar rritje.

6 ECURIA E RREZIQEVE NË SISTEMIN BANKAR DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA

6.1 Zhvillimet kryesore në ecurinë e sistemit bankar shqiptar

Treguesi më i rëndësishëm i mbikëqyrjes, ai i mjaftueshmërisë së kapitalit, në fund të vitit 2025, raportohet në nivelin 20.4%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky tregues shfaqet me një rënie të lehtë prej 0.15 pikësh përqindjeje.

Po kështu, edhe treguesi i kredive me probleme ka pësuar një rënie prej 0.38 p.p. në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 3.8% në fund të vitit 2025. Në vlerë absolute, kredia me probleme arriti në rreth 35.9 miliardë lekë, në rritje me rreth 1 miliard lekë ose 3% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, portofoli i kredisë rezulton në rritje me rreth 108.5 miliardë lekë ose 13.9% gjatë këtij viti.

Treguesit e përfitueshmërisë – përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali aksionar mesatar (RoAE) – shfaqen në rënie krahasuar me vitin 2024. Vlerat, në fund të vitit 2025, rezultojnë në 1.64% për RoAA dhe 15.9% për RoAE, ndërsa në fund të vitit 2024, këta tregues ishin përkatësisht 1.82% dhe 17.9%.

Zhvillimet kryesore të veprimtarisë bankare, gjatë vitit 2025, përmbledhen si më poshtë:


1. Treguesi i kredive me probleme ka pësuar një rënie prej 0.38 p.p. në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 3.8% në fund të vitit 2025;
2. Teprica e kredisë me probleme neto ndaj totalit të portofolit të kredisë neto paraqitet në nivelin 1.4%, në rënie me 0.37 p.p. krahasuar me dhjetorin 2024;
3. Mbulimi me provigjione i kredive me probleme rezulton 64.37%, rreth 12 p.p. më i ulët në harkun kohor të një viti;
4. Treguesit e likuiditetit në mënyrë të vazhdueshme paraqiten ndjeshëm mbi normat e parashikuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë. Në dhjetor 2025, raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar rezultoi 43.3%, me një rritje prej 1.54 pikësh përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
5. Raporti i mbulimit me likuiditet rezulton në nivelin 273.3% përkundrejt limitit rregullator prej 100%;
6. Në dhjetor 2025, vlera totale e depozitave të sistemit arrin në 1.836 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 9.1% krahasuar me një vit më parë. Pesha e monedhës vendase në totalin e depozitave është rritur në 48.6%, nga 47.6% në dhjetor 2024;

7. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si tregues thelbësor mbikëqyrës, në fund të vitit 2025, raportohet në nivelin 20.4%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky tregues shfaqet me një ulje të lehtë prej 0.15 pikësh përqindjeje;
8. Rezultati financiar i sistemit shënon nivelin 35.6 mld lekë, në rënie me rreth 1 miliardë apo 2.9% më pak se në vitin 2024.

6.2 Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës

Kapitali aksionar i sistemit bankar arriti në vlerën 235.65 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 21.08 miliardë lekësh ose 9.8% kundrejt një viti më parë. Struktura e kapitalit vijon të dominohet nga kapitali i huaj, i cili në fund të vitit 2025, përfaqëson rreth 68.29% të kapitalit të paguar të sistemit bankar, me një rënie prej rreth 2.11 pikësh përqindjeje kundrejt fundit të vitit 2024.

Grafik 5. Struktura e kapitalit në sistemin bankar, sipas origjinës, dhe ecuria e saj në kohë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.3 Struktura e sistemit bankar

6.3.1 Aktivitet dhe pasivët, struktura e tyre

Gjatë vitit 2025, aktivet e sistemit bankar shënuan një rritje prej rreth 197.84 miliardë lekësh ose 9.47%, përkundërt rritjes me 126.53 miliardë lekë ose 6.43% të një viti më parë.

Pesha që zë sistemi bankar në ekonomi, e shprehur nëpërmjet raportit të totalit të aktiveve ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ka shënuar një rënie të konsiderueshme me rreth 4 p.p., duke arritur në nivelin 86.31%. Raporti i kredive ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto ka shënuar

një rënie të lehtë me 0.36 p.p., si pasojë e rritjes më të madhe të PBB-së përkundrejt rritjes së portofolit të kredive.

Tabelë 2. Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj PBB-së

Treguesit	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Totali i aktiveve (në mld lekë)	1,580.82	1,773.29	1,875.84	1,963.75	2,090.28	2,288.12
Totali i aktiveve/PBB (në %)	93.43	107.64	101.06	92.00	90.39	86.31
Totali i kredive/PBB (në %)	35.99	40.73	38.52	34.65	36.06	35.70

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e aktiveve të sistemit bankar, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shfaq këto zhvillime kryesore:

- rënie të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare me 7.2 miliardë lekë ose 1.59%, e cila buron kryesisht nga rënia e marrëdhënieve me bankat e tjera me 17.2 miliardë lekë, ose 11.40%;
- rritje të veprimeve me klientët (neto) me 115.9 miliardë lekë ose me 14.36%;
- rritje të veprimeve me letrat me vlerë (neto) me 79.3 miliardë lekë ose me 10.21%;
- rritje të mjeteve të tjera me 7.6 miliardë lekë ose me 30.50%;
- rritje të mjeteve të qëndrueshme me 2.3 miliardë lekë ose me 7.52%.

Tabelë 3. Ecuria e zërave kryesorë të aktiveve të sistemit bankar

Treguesit:	Dhjetor 2024			Dhjetor 2025		
	Shuma*	Pesha*	Ndryshim i %***	Shuma*	Pesha*	Ndryshim i %***
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	451.8	21.6	(11.68)	444.6	19.4	(1.59)
Nga të cilat:						
- Mjete monetare	43.0	2.1	38.41	46.3	2.0	7.74
- Marrëdhënie me bankën qendrore	170.5	8.2	(23.97)	172.6	7.5	1.26
- Bono thesari	87.3	4.2	(16.28)	91.9	4.0	5.18
- Marrëdhënie me bankat e tjera	151.0	7.2	(0.81)	133.8	5.8	(11.40)
2. Veprime me klientët (neto)	807.3	38.6	9.30	923.2	40.3	14.36
3. Veprimet me letrat me vlerë (neto)	775.9	37.1	13.64	855.2	37.4	10.21
4. Mjete të tjera	24.6	1.3	(10.19)	32.2	1.4	30.50
5. Mjete të qëndrueshme	30.6	1.5	4.13	32.9	1.4	7.52
Totali i aktiveve	2,090.3	100.0	6.44	2,288.1	100.0	9.46

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Zërat 1, 2, 3 të tabelës së mësipërme përfshijnë edhe interesat e përllogaritura.

** në miliardë lekë*

*** në % ndaj totalit të aktivitetit*

**** në % ndaj një viti më parë*

Struktura e detyrimeve të sistemit bankar, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shfaq këto zhvillime kryesore:

- rritje të veprimeve me thesarin dhe ndërbankare me 6.65 miliardë lekë ose 5.38%;
- rritje me 153.2 miliardë lekë ose 9.1% të zërit “Veprime me klientët”, të cilat mbartin peshën më të madhe të pasiveve të sistemit bankar me 80.5%;
- rritje të veprimeve me letrat me vlerë prej 10.0 miliardë lekë ose 80.48%, por pesha e tyre mbetet e vogël;
- rënie të detyrimeve të tjera me 0.5 miliardë lekë ose 2.20%;
- rritje të burimeve të përhershme me 28.54 miliardë lekë ose 11.49%.

Tabelë 4. Ecuria e zërave kryesorë të pasiveve të sistemit bankar

Treguesit:	Dhjetor 2024			Dhjetor 2025		
	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi %***	Shuma*	Pesha**	Ndryshimi %***
1. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	123.6	5.9	23.0	130.3	5.7	5.38
2. Veprime me klientët	1,683.1	80.5	4.9	1,836.2	80.3	9.10
3. Veprime me letrat me vlerë	12.4	0.6	69.3	22.4	1.0	80.48
4. Detyrime të tjera	22.8	1.1	(2.2)	22.3	1.0	(2.20)
5. Burime të përhershme	248.4	11.9	9.1	277.0	12.1	11.49
Totali i pasivit	2,090.3	100.0	6.4	2,288.1	100.0	9.46

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* në miliardë lekë

** në % ndaj totalit të pasivit

*** në % ndaj një viti më parë

Gjatë vitit 2025, pesha e zërave jashtë bilancit ndaj aktiveve totale të sistemit ka pësuar një rritje të lehtë, duke arritur në nivelin 97.89%, nga 96.48% që ishte në fund të vitit 2024. Zërat jashtë bilancit kanë pësuar rritje në vlerë me 222.8 miliardë lekë dhe, siç ilustron në tabelën më poshtë, gjatë këtij viti, rritja vjetore ka ardhur si pasojë e rritjes së angazhimeve të marra, kryesisht për shkak të rritjes së garancive të marra. Në strukturën e zërave jashtë bilancit, angazhimet e marra janë elementi më i rëndësishëm, me një peshë prej rreth 91.9%, nga 91.5% që ishte ky tregues në fund të vitit 2024.

Tabelë 5. Ndryshimi me vitin paraardhës i zërave jashtë bilancit

Treguesit:	Ndryshimi me vitin paraardhës		Dhjetor 2024	Ndryshimi me vitin paraardhës		Dhjetor 2025
	Dhjetor 2024			Dhjetor 2025		
	Në mld lekë	Në %		Në mld lekë	Në %	
TOTALI	585.2	31.1	2,016.9	222.8	11.0	2,239.7
Angazhime të dhëna	(5.9)	(4.3)	132.9	12.3	9.2	145.2
Nga të cilat:						

- Angazhime financimi	(8.5)	(10.3)	74.3	0.5	0.6	74.8
- Garanci	(1.3)	(2.7)	45.6	(0.5)	(1.2)	45.1
- Angazhime për letrat me vlerë	3.8	42.1	13.0	12.3	95.2	25.3
Angazhime të marra	141.5	8.3	1,845.5	213.1	11.5	2,058.6
Nga të cilat:						
- Angazhime financimi	(5.8)	(34.7)	10.9	(0.5)	(4.9)	10.4
- Garanci	148.6	8.9	1,828.1	202.4	11.1	2,030.5
Transaksione në valutë	2.4	11.7	23.2	(2.3)	(9.9)	20.9
Angazhime të tjera	(0.0)	(0.8)	2.4	(0.0)	(1.6)	2.4
Angazhime për instrumente financiare	(2.8)	(17.7)	12.9	(0.3)	(2.3)	12.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.3.2 Përqendrimi

Treguesi i përqendrimit, i shprehur nëpërmjet indeksit *Herfindahl* të përlogaritur për totalin e aktiveve, paraqitet pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2024, ndërsa për totalin e depozitave dhe indeksin e kredisë evidentohet në rënie me 0.01 p.p. Megjithatë, të tre treguesit paraqiten në nivele të ulëta.

Tabelë 6. Indeksi H* (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë

Treguesit	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Indeksi H (aktivet)*	0.15	0.15	0.14	0.15	0.14	0.14
Indeksi H (depozita)	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.14
Indeksi H (kredia)	0.12	0.12	0.12	0.13	0.13	0.12

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* Vlerat e këtij treguesi luhaten në vlerat 0 deri në 1, ku vlerat më afër 0 përfaqësojnë nivele të ulëta përqendrimi.

6.4 Administrimi i rreziqeve në veprimtarinë bankare

6.4.1 Rreziku i kredisë

6.4.1.1 Aktiviteti kreditues

Gjatë vitit 2025, totali i kredisë pësoi një rritje prej 112.45 miliardë lekësh, ose rreth 13.9% krahasuar me vitin 2024.


Tabelë 7. Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit

Rritja tremujore e kredisë	Mars 2025	Qershor 2025	Shtator 2025	Dhjetor 2025
Në milionë lekë	33,595.18	26,247.45	8,044.54	44,565.96
Në %	4.03%	3.03%	0.90%	4.94%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025 evidentohet një rritje e portofolit të kredisë në të katër tremujorët. Rritja më e lartë rezulton në tremujorin e fundit të vitit me 4.94%, si dhe në tremujorin e parë me 33.6 mld lekë ose 4.03%. Ndërkohë, për sa i përket rritjes mujore, në muajt mars dhe nëntor 2025 është evidentuar rritja më e madhe e portofolit të kredisë me përkatësisht 2.21% dhe 2.24%. E mesatarizuar, rritja mujore ka qenë në nivelin prej 1.06%.


Grafik 6. Ecuria e rritjes mujore të kredisë gjatë vitit 2025 (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e kredisë sipas **llojit të subjektit** evidenton një përqendrim më të lartë në sektorin privat, rreth 58.4%, në rënie 1.8 p.p., ndërkohë kreditimet për këtë sektor gjatë vitit 2025 janë rritur me rreth 50.8 miliardë lekë (10%). Edhe kredia për individë rezulton në rritje me 61.6 miliardë lekë (19.9%), duke kontribuar në një rritje të peshës së saj me 2.1 p.p. Kredia dhënë sektorit publik evidenton një rritje të papërfillshme (0.13%).

Grafik 7. Teprica e kredisë akorduar biznesit dhe individëve ndaj tepricës totale të kredisë (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza sipas **subjektit dhe qëllimit të përdorimit**³ të kredisë evidenton se “huaja për blerje banesash” për individët zë peshën më të madhe ndaj totalit të portofolit të kredisë me 26.8%, pasuar nga “huaja për pasuri të paluajtshme” nga biznesi me 24.3%, “overdraft-i” dhënë bizneseve me 13.3%, dhe “kredia për blerje pajisjesh” me 11.6% të totalit.

Rritjen më të lartë gjatë vitit 2025 e shfaq kredia dhënë individëve për “qëllime të tjera” me 55.3%, dhe për “mallra të qëndrueshëm” me 29%.

Tabelë 8. Kredia, sipas sektorit dhe qëllimit të përdorimit (vlera në miliardë lekë dhe pesha e secilit zë ndaj kredisë gjithsej)

PËRSHKRIMI	Dhjetor 2024	Pesha në %	Ndryshimi në % Dhjetor 2024 - Dhjetor 2023	Dhjetor 2025	Pesha në %	Ndryshimi në % Dhjetor 2025 - Dhjetor 2024
Kredia gjithsej	779.3	100.0	12.4	887.8	100.0	13.9
Kredia dhënë biznesit	469.7	60.3	11.4	516.6	58.2	10.0
Overdraft	103.7	13.3	2.3	108.4	12.2	4.5
Kapital qarkullues	79.5	10.2	8.6	86.2	9.7	8.4
Hua për çelje biznesi	6.5	0.8	(18.9)	5.1	0.6	(21.3)
Blerje pajisjesh	90.3	11.6	16.6	100.2	11.3	11.0
Pasuri të paluajtshme	189.3	24.3	17.4	216.4	24.4	14.3
Hua për investime në instrumente financiare	0.3	0.0	(43.8)	0.3	0.0	(15.3)
Kredia dhënë individëve	309.6	39.7	13.9	371.2	41.8	19.9
Overdraft	8.7	1.1	(3.5)	9.4	1.1	8.5
Mallra jo të qëndrueshme	51.2	6.6	21.6	61.9	7.0	20.8
Mallra të qëndrueshme	28.1	3.6	10.2	36.3	4.1	29.0
Hua për blerje banesash	208.7	26.8	15.5	243.6	27.4	16.7
Hua për qëllime të tjera	12.9	1.7	(10.5)	20.0	2.3	55.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Të dhënat e tabelës së mësipërme i referohen vetëm klientëve rezidentë, jopublikë, dhe në to nuk përfshihen interesat e përlllogaritura.

Struktura e kredisë **sipas afatit** ka shënuar një rënie të peshës së kredive afatshkurtra dhe rritje të peshës së kredive afatmesme dhe afatgjata. Rritjen më të madhe në vlerë e ka pasur kredia afatgjatë me 50 mld lekë ose 19%, pasuar nga kredia afatmesme me 18.2 mld lekë ose 18.9%.


Tabelë 9. Struktura e tepricës së kredisë, sipas afatit (në përqindje)

Afati i maturimit	Dhjetor 2024	Mars 2025	Qershor 2025	Shtator 2025	Dhjetor 2025
Afatshkurtër	20.4	20.9	20.0	18.1	17.9
Afatmesme	12.2	12.0	12.1	12.5	12.7
Afatgjatë	33.5	33.2	33.1	34.7	35.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

³ Të dhënat nuk përfshijnë jorezidentët.

Grafik 8. Vëllimi i tepricës së kredisë, sipas monedhave (në miliardë lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Portofoli i kredive **sipas monedhës**, për vitin 2025, evidenton se kredia në Lek ka peshën më të madhe në totalin e kredisë, me 55.8%, me një rritje prej 1.1 p.p.

Tabelë 10. Struktura e tepicës së kredisë sipas monedhës (në përqindje)


Monedha	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025
Lekë	48.6	53.7	54.7	55.8
Valutë	51.4	46.3	45.3	44.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025, pesha e **kredisë në valutë** - e klasifikuar si **e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit** - ndaj totalit të portofolit në valutë⁴, ka shfaqur një rënie me 5.1 p.p. në krahasim me vitin paraardhës, duke arritur në nivelin 18.54%.

⁴Përcaktimi për kreditë e pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit jepet në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, nr. 62, datë 14.9.2011, "Për administrimin e rrezikut të kredisë", neni 4, pika 2, shkronja "c".

Grafik 9. Pesha e kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndaj portofolit të kredisë në valutë (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë⁵, për vitin 2025, evidenton kreditim më të madh të bizneseve kundrejt individëve. Sektorët më të kredituar të ekonomisë vazhdojnë të mbeten “Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave” me një peshë prej 30.2% të portofolit, pasuar nga sektori i “Ndërtimit” me një peshë prej 15.8% dhe sektori i “Industriës përpunuese” me një peshë prej 11.9%.

Tabelë 11. Kredia sipas degëve të ekonomisë (në vlerë, miliardë lekë, dhe sipas peshës ndaj totalit të kredive)

Përshkrimi	Dhjetor 2024		Dhjetor 2025	
	Në vlerë	Pesha në %	Në vlerë	Pesha në %
Bizneset	469.7	60.3	516.6	58.2
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	6.3	1.3	6.8	1.3
Industria nxjerrëse	3.6	0.8	3.0	0.6
Industria përpunuese	57.3	12.2	61.7	11.9
Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	39.7	8.4	47.2	9.1
Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2.0	0.4	2.1	0.4
Ndërtimi	77.8	16.6	81.6	15.8
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	140.9	30.0	155.9	30.2
Transporti dhe magazinimi	20.6	4.4	26.5	5.1
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	44.0	9.4	50.3	9.7

⁵Të dhënat nuk përfshijnë jorezidentët.

Informacioni dhe komunikacioni	9.4	2.0	8.1	1.6
Aktivite financiare dhe të sigurimit	4.1	0.9	4.6	0.9
Aktivite të pasurive të paluajtshme	19.0	4.0	25.5	4.9
Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	5.3	1.1	5.2	1.0
Shërbime administrative dhe mbështetëse	6.9	1.5	9.6	1.9
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	0.1	0.0	0.2	0.0
Arsimi	3.9	0.8	3.4	0.7
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	6.9	1.5	7.0	1.4
Arte, argëtim dhe çlodhje	2.5	0.5	1.3	0.2
Aktivite të tjera shërbimi	19.2	4.1	16.7	3.2
Aktivite të familjeve si punëdhënës; Aktivite të prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet	0.2	0.0	0.1	0.0
Aktivite të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	0.0	0.0	0.0	0.0
Individët	309.6	39.7	371.2	41.8
Totali	779.3	100.0	887.8	100.0


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Të dhënat e tabelës i referohen vetëm klientëve rezidentë dhe nuk përfshihen interesat e përlllogaritura.

6.4.1.2 Cilësia e aktiveve


Në fund të vitit 2025, kredia me probleme arriti në nivelin 35.9 miliardë lekë, duke u rritur me 1 miliard lekë ose 3% krahasuar me një vit më parë. Treguesi i kredive me probleme bruto ka pësuar një rënie prej 0.38 p.p. në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 3.8% në fund të vitit 2025.

Grafik 10. Ecuria e portofolit të kredive me probleme dhe e portofolit të kredive, krahasuar me tremujorin paraardhës (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Ecuria e tepricës së kredisë me probleme në sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Teprica e kredisë me probleme neto ndaj totalit të portofolit të kredisë neto paraqitet në nivelin 1.4%, në rritje me 0.37 p.p. krahasuar me dhjetorin 2024.

Në portofolin e kredive të rregullta, evidentohet rritje e kredive të klasifikuara “standard” me 1.2 p.p. Ndërsa në portofolin e kredive me probleme, evidentohet një rritje e klasës së kredive të klasifikuara “nënstandard” me 0.4 p.p., ndërkohë që vihet re një ulje për klasën e kredive “të humbura” me 0.9 p.p. Kreditë e dyshimta mbeten në të njëjtin nivel.


Tabelë 12. Pësia e tepricës së kredisë sipas klasave (në përqindje)

Klasifikimi i kredisë	2024				2025			
	T I	T II	T III	T IV	T I	T II	T III	T IV
Standard	92.2	92.2	92.7	93.4	93.0	94.0	94.2	94.6
Në ndjekje	3.3	3.1	2.8	2.5	3.1	2.1	1.5	1.7
Nënstandard	1.3	1.3	1.2	0.9	1.0	1.4	1.5	1.3
Të dyshimta	0.7	1.1	0.9	0.7	0.6	0.5	0.7	0.7
Të humbura	2.5	2.3	2.4	2.6	2.3	2.0	2.1	1.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë rezultojnë në 23.1 miliardë lekë, me një ulje prej rreth 3.5 miliardë lekësh ose 13.2% kundrejt një viti më parë; ndërsa mbulimi i kredive me probleme me fonde rezervë për humbjet nga kreditë është 64.37%, rreth 12 pikë përqindje më i ulët në harkun kohor të një viti.


Grafik 12. Fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i kredive me probleme neto ndaj kapitalit rregullator është rritur me 1.36 pikë përqindjeje në krahasim me një vit më parë, si rezultat i rritjes së kredive me probleme neto me 4.5 miliardë lekë ose 56%, ndërkohë që kapitali rregullator është rritur me 29.4 miliardë lekë ose 14%.


Grafik 13. Ecuria e raportit kredi me probleme neto/kapital rregullator



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket cilësisë së kredisë të ndarë sipas llojit të subjektit, treguesi i kredisë me probleme për biznesin ka rënë me 0.5 p.p., duke shkuar në nivelin e 4.7%, ndërkohë që edhe për individët ka rënë me 0.3 pikë përqindjeje kundrejt një viti më parë, duke qëndruar në nivelin 2.6%.


Grafik 14. Teprica e kredisë me probleme për bizneset dhe individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket ndarjes së kredisë me probleme sipas monedhës, rezulton se treguesi i kredisë me probleme në valutë ka pësuar një rënie me 0.6 p.p., duke arritur në nivelin 2.8%. Gjithashtu, edhe treguesi i kredisë në Lek ka pësuar një rënie, por më të lehtë, me 0.2 p.p., duke arritur në nivelin 4.6% në fund të vitit 2025.

Grafik 15. Teprica e kredisë me probleme sipas monedhave




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i kredisë me probleme të portofolit të kredisë në valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është në nivelin 4.02%, me një rritje prej vetëm 0.15 p.p. kundrejt fundit të vitit 2024. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rënies së konsiderueshme të tepricës së kredisë në

valutë të pambrojtura ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, me 12.8%, kundrejt rënies së kredive me probleme në valutë të pambuluara nga rreziku i kursit të këmbimit me 9.5%.

Grafik 16. Ecuria 3-mujore e raportit "kredi me probleme në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit/ teprica e kredisë në valutë e pambrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit"



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga të dhënat e raportuara, rezulton se pjesa më e madhe e portofolit të kredive (76.4%) është e kolateralizuar, duke u rritur në peshë me 0.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Referuar llojit të kolateralit, pjesa më e madhe e kredive të sistemit, rreth 46.1%, është e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme. Me këtë lloj kolaterali, kreditë për individët kanë një nivel më të lartë mbulimi me kolateral me pasuri të paluajtshme krahasuar me kreditë për bizneset.

Tabelë 13. Llojet e kolateraleve të shpërndara sipas sektorëve dhe monedhëve (në përqindje)

Llojet e kolateralit	Individë		Biznes		Total	
	lekë	valutë	lekë	valutë	lekë	valutë
Pasuri të paluajtshme	58%	72%	37%	36%	48%	44%
Cash	1%	5%	2%	2%	1%	3%
Kolateral tjetër	6%	15%	38%	44%	21%	38%
Kredi e pakolateralizuar	35%	9%	24%	18%	30%	16%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike analizat e provës së rezistencës (*stress-test*) për të matur qëndrueshmërinë e kapitalit të bankës në përballimin e rreziqeve të veprimtarisë bankare. Këto analiza tregojnë se niveli aktual i kapitalit të sistemit bankar është i mjaftueshëm për të përballuar një nivel relativisht të lartë të humbjeve që mund të vijnë, si rezultat i ekspozimeve ndaj rrezikut të kredisë. Kjo aftësi e kapitalit për të përballuar humbjet e mundshme ka qenë konstante përgjatë gjithë vitit 2025.

6.4.2 Rreziku i likuiditetit

Situata e përgjithshme e likuiditetit të sistemit bankar, gjatë vitit 2025, ka vijuar të provojë qëndrueshmëri, duke paraqitur një ekspozim relativisht të ulët ndaj rrezikut të likuiditetit. Rritja e qëndrueshme e nivelit të depozitave, si kontribuues kryesor i financimit të aktivitetit të bankave, niveli dy herë më i lartë i treguesit të likuiditetit kundrejt minimumit rregullator (i llogaritur si raport i aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra), niveli i ulët i treguesit kredi ndaj depozitave, si dhe aftësia e sistemit për të gjeneruar likuiditet në rastet e materializimit të situatave të jashtëzakonshme, përbëjnë një kuadër të kënaqshëm për mbrojtjen ndaj rrezikut të likuiditetit. Treguesit e likuiditetit, në mënyrë të vazhdueshme, paraqiten ndjeshëm mbi normat e parashikuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Në dhjetor 2025, raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra për sistemin bankar rezultoi 43.3%, me një rritje prej 1.54 pikë përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja vjen si pasojë e rritjes me ritme më të larta të aktiveve likuide krahasuar me rritjen e pasiveve afatshkurtra. Aktivët likuide kanë njohur një rritje me 13.2%, ndërkohë që pasivet afatshkurtra janë rritur vetëm me 9.2%. Lëvizjet kryesore në aktivët likuide rezultojnë në rritjen e investimeve në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në ato të emetuara nga qeveritë qendrore dhe/ose bankat qendrore me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare, si dhe llogarive me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyruar deri në masën e përdorimit të saj. Rritja vjen nga aktivët në valutat kryesore si EUR dhe USD.

Treguesi i likuiditetit në valutë, në dhjetor 2025, paraqitet në nivelin 32.64% (nga 28.55% që ishte në dhjetor 2024), si rezultat i rritjes më të madhe të aktiveve likuide në valutë kundrejt rritjes së pasiveve afatshkurtra po në valutë. Rritja më e madhe e aktiveve në valutë vjen nga investimet në letra me vlerë të emetuara nga qeveritë qendrore, bankat qendrore dhe institucionet financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare, si dhe nga investime në letra me vlerë në valutë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Në krahun e pasiveve, ndryshimet në kursin e këmbimit, me vlerësimin e monedhës Lekë, përcillen me ritme rritjeje relativisht më të ulëta të depozitave në valutë të klientëve. Aktivët likuide në Lek vijnë të mbeten mbështetëset

kryesore të likuiditetit në nivelin 61.35% të totalit të aktiveve likuide (63.56% të totalit të aktiveve likuide në muajin dhjetor të vitit 2024).

Raporti i Mbulimit me Likuiditet (RML) raportohet në nivelin 273.3%, i përcaktuar kryesisht nga treguesi në Lek. I ndarë në monedhën vendase dhe monedhë të huaj, treguesi në Lek qëndron në nivelin 307.9%, ndjeshëm më i lartë se ai i monedhave të huaja të rëndësishme që raportohet në nivelin 206.4%. Kjo vjen si rezultat i strukturës së aktiveve likuide, të cilat dominohen nga letrat me vlerë në Lek të Qeverisë Shqiptare.

Raporti Neto i Financimit të Qëndrueshëm të Bankave (RNFAQ). Për bankat josistemike, rregullorja përcakton qartë llogaritjen e thjeshtuar të këtij treguesi, ndërkohë që bankat sistemike duhet të përdorin llogaritjen bazë. Raporti RNFAQ, në total për dhjetorin 2025, për bankat sistemike dhe ato të cilat kanë zgjedhur llogaritjen bazë, raportohet në nivelin 198%; në monedhën vendase në nivelin 187%; dhe në valutë 208%. Raporti RNFAQ i llogaritur sipas mënyrës së thjeshtësuar qëndron në nivelin 154% në total, 166% në monedhën vendase dhe 139% në valutë.

6.4.2.1 Depozitat e sistemit

Depozitat e klientëve mbeten burimi kryesor i financimit për sistemin bankar shqiptar, me një peshë prej 80.2% (80.5% në dhjetor 2024) të totalit të pasivit. Në dhjetor 2025, vlera totale e depozitave të sistemit arriti në 1.836 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 9.1% krahasuar me një vit më parë. Peshë e monedhës vendase në totalin e depozitave ka arritur në 48.6%, nga 47.6% që shënonte ky tregues në dhjetor të vitit 2024. Struktura e tipologjisë përgjatë vitit 2025 reflekton një rritje më të lartë në llogaritë rrjedhëse pasuar nga depozita me afat, ndërkohë që depozitat pa afat kanë njohur një rritje të lehtë. Struktura e maturiteteve peshon në afatet më të shkurtra, ndërkohë që viti 2025 vijon të ruajë një zhvendosje në drejtim të afateve më të gjata.

6.4.2.2 Përqendrimi i depozitave

Lidhur me përqendrimet e depozituesve më të mëdhenj, në dhjetor 2025, dhjetë depozituesit më të mëdhenj zënë 7.53% të totalit të depozitave të sistemit bankar, kundrejt 7.35% që zinin në dhjetor 2024. Depozitat e individëve mbeten baza kryesore e depozitave të sistemit, me një peshë prej 78.4% të totalit të depozitave, i njëjti nivel si një vit më parë. Gjatë këtij viti, ritmet më të larta në rritje i ka pasur sektori privat dhe sektori individ (përkatësisht me 9.3% dhe 9.2%), ndërkohë që sektori publik ka njohur një rritje më të lehtë me 6.1%.

6.4.2.3 Treguesi kredi ndaj depozitave

Raporti kredi/depozita, në dhjetor 2025, paraqitet në nivelin 51.54% (dhjetor 2024: 49.55%) dhe reflekton një strukturë të aktiv-pasiveve që krijon lehtësi në administrimin e likuiditetit, si dhe stimuj potencialë në kredidhënie. Gjatë vitit 2025, treguesi është zgjeruar, për shkak të ritmeve të ndryshme të ecurisë së portofolit të kredisë dhe totalit të depozitave (ku portofoli i kredisë ka njohur rritje më të lartë, kundrejt rritjes së depozitave). Raporti midis monedhës vendase dhe monedhave të huaja, gjatë këtij viti, është më i lartë në monedhën vendase, në nivelin 59.1%, ndërkohë që në valutë ky tregues qëndron në nivelin prej 44.3%. Treguesit, si në valutë ashtu edhe në monedhën vendase, kanë njohur zgjerim kundrejt një periudhe më parë.

6.4.2.4 Aktivët likuide të sistemit

Gjatë vitit 2025, aktivët likuide janë rritur me 79.2 miliardë lekë ose me 12.2%. Rritja ka ardhur nga investimet në letra me vlerë në valutë, ndërkohë që monedha vendase ka njohur rritje në drejtim të investimeve në aktive likuide me 35 miliardë lekë ose 9.2%. Portofoli i investimeve në letra me vlerë vijon të përbëjë peshën më të madhe të aktiveve likuide. Investimet në llogaritë bankare apo të institucioneve financiare në formën e llogarive rrjedhëse, depozitave apo huave, kanë njohur rënie. Totali i aktiveve likuide të sistemit bankar, në dhjetor 2025, arriti në 678 miliardë lekë, dhe në strukturën e tyre peshën kryesore e zënë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare (me 54.9%, nga 56% në dhjetor 2024).

Kështu, në dhjetor të vitit 2024, niveli i totalit të aktiveve likuide të sistemit bankar shënoi vlerën 598 miliardë lekë, dhe në strukturë peshën kryesore e zënë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare (me 56%, nga 51.9% në dhjetor 2023).

6.4.2.5 Burimet e tjera financiare

Burimet e tjera financiare të sistemit bankar kanë një peshë relativisht të vogël në totalin e pasiveve, me rreth 5.7%. Ato rezultojnë me një zgjerim të lehtë gjatë vitit (dhjetor 2024: 5.9%). Pjesa kryesore e këtij zëri përfaqësohet nga detyrimet ndaj institucioneve financiare dhe marrëveshjet e riblerjes.

6.4.2.6 Provat e rezistencës

Provat e rezistencës, si rezultat i aplikimit të skenarëve të ndryshëm me ngjarje të paparashikuara dhe faktorë që mund të ndikojnë negativisht në likuiditet, kanë treguar se të gjitha bankat mund të përballojnë me sukses situata të tilla në disa nga skenarët.

6.4.3 Rreziqet e tregut

Situata e përgjithshme e ekspozimit të sistemit bankar ndaj rreziqeve të tregut, gjatë vitit 2025, ka qëndruar relativisht në nivele të ulëta. Në vlerësimin e rreziqeve të tregut në librin e tregtueshëm dhe në librin e bankës janë përfshirë treguesit (faktorët e rrezikut) e ekspozimit ndaj: ndryshimit të normës së interesit në librin e bankës; rrezikut të kursit të këmbimit në të gjithë bilancin; rrezikut të pozicionit (në mënyrë specifike, ndryshimit të normave të interesit në portofolin e tregtueshëm dhe të vendosjes jorezident), si dhe aftësisë mbrojtëse të kapitalit për mbulimin e humbjeve të mundshme nga këto rreziqe. Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut zë 1.78% të totalit të ekspozimeve të ponderuara me rrezik. Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut në nivel sistemi përbën vetëm 0.81% të kapitalit rregullator. Ky ekspozim vjen ndaj rrezikut të kursit të këmbimit dhe pozicionit të titujve të borxhit.

Rreziku i tregut me burim ekspozimin ndaj normës së interesit (matur si ndryshimi i vlerës së ekspozimit në librin e bankës, pas goditjes standarde të normës së interesit, kundrejt kapitalit rregullator), tregon për një rrezik mesatarisht të ulët të strukturës së riçmimit të aktiveve dhe pasiveve të sistemit bankar. Vlera e këtij treguesi, në muajin dhjetor të vitit 2025, është 5.49%, krahasuar me 5.46% në dhjetor 2024. Diferenca nga mesatarja vjen nga disa banka të veçanta, si pasojë e ndryshimeve të maturitetit mesatar të portofolit të kredisë dhe investimeve në letra me vlerë. Megjithatë, vlen të përmendet këtu se treguesit mbeten ende brenda limiteve dhe larg kufijve rregullatorë.

Rreziku i tregut me burim ekspozimin nga kursi i këmbimit, i vlerësuar nga dinamika e pozicionit të hapur valutor, vijon të shfaqet i ulët, sjellje e cila ka qenë mbizotëruese gjatë gjithë periudhës vjetore. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në dhjetor 2025, rezultoi “në blerje” në masën 15.5 miliardë lekë, ose 6.69% e kapitalit rregullator të sistemit bankar, nivele këto larg limitit rregullator prej 20%.

Rreziku i tregut në portofolin e tregtueshëm për sistemin bankar është shumë i vogël dhe vlerësohet i tillë përgjatë gjithë ecurisë vjetore të analizuar.

Portofoli i tregtueshëm në nivel sistemi shfaqet mjaft i ulët ndaj totalit të aktiveve (0.43% në dhjetor 2025, nga 0.21% që ishte në dhjetor 2024). Rreziku i tregut me burim normën e interesit në portofolin jorezident të vendosjes dhe të tregtueshëm (portofoli jorezident i vendosjes mbart faktorë të rrezikut të tregut) vlerësohet në nivele të ulëta kundrejt totalit të aktiveve.

Provat e rezistencës për rrezikun e kursit të këmbimit, duke përdorur skenarë të ndryshëm të goditjes (ndryshimit) së kursit të këmbimit, tregojnë se si bankat individuale, ashtu edhe sistemi bankar në tërësi, janë në gjendje të përballojnë skenarët e parashikuar.

6.4.4 Rreziku operacional

Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren e re nr. 53, datë 06.11.2024, “Për Administrimin e Rrezikut Operacional nga Bankat, Institucionet e Pagesave dhe Institucionet e Parasë Elektronike”. Kjo rregullore paraqet një qasje më të përparuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj administrimit të rrezikut operacional, duke përcaktuar disa kërkesa më cilësore dhe më të shpeshta për raportim ndaj Bankës së Shqipërisë. Raportimet e para, bazuar në këtë rregullore, janë paraqitur nga bankat për tremujorin e dytë të vitit 2025.

Humbjet e raportuara⁶ nga bankat për vitin 2025 tregojnë një trend në ulje të ekspozimit bruto ndaj rrezikut operacional, i cili rezulton rreth 146 milionë lekë nga 598 ngjarje të raportuara krahasuar me rreth 305 milionë lekë humbje nga 1,951 ngjarje të raportuara gjatë vitit 2024. Në total, këto humbje përfaqësojnë rreth 49% të humbjeve totale të regjistruara gjatë vitit 2024.

Pas rikuperimeve të realizuara, **humbja neto u ul në 77.9 milionë lekë**, duke rezultuar në një shkallë rikuperimi prej rreth 47%.

Rezultatet për fundin e vitit 2025 tregojnë se humbjet operacionale të bankave paraqiten përgjithësisht me materialitet të ulët, duke reflektuar kapacitete të mira për përthithjen e tyre. Për shumicën e bankave, raporti humbje/NBI⁷ mbetet nën 1%, ndërsa raporti humbje/KRO⁸ në nivele të përballueshme. Vlerat më të larta të regjistruara për raportin humbje/NBI luhaten midis vlerave 0.93% - 2.09% dhe për raportin humbje/KRO në nivelet 8.06% - 14.71%. Për raste të tjera shfaqen nivele minimale, duke sinjalizuar materialitet të papërfillshëm të humbjeve operacionale.

6.4.4.1 Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK)

Gjatë vitit 2025, është shënuar përmirësim në cilësinë e administrimit të rrezikut të TIK-ut, me një vëmendje të shtuar ndaj rrezikut kibernetik. Kjo vjen për shkak të faktit se bankat po bëhen gjithnjë e më të varura nga shërbimet dhe sistemet digjitale, ndërsa përballen me një rritje të numrit të kërcënimeve kibernetike. Mbikëqyrja bankare ndjek një sërë strategjish për të krijuar dhe mirëmbajtur një hapësirë të sigurt kibernetike në sektorin bankar. Këto strategji përfshijnë masa teknologjike, organizative dhe rregullatore, të cilat synojnë mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve financiare nga sulmet kibernetike dhe rreziqet e tjera.

⁶ Vlerat e raportuara janë vetëm për T2, T3 dhe T4, për shkak të ndryshimeve në formatet e raportimit.

⁷ NBI- Net Business Income/ të ardhurat neto të veprimtarisë bankare.

⁸ KRO-Kapitali i Rrezikut Operacional.

Në këtë kuadër, bazuar në “Udhërrëfyesin e Vetëvlerësimit të Rrezikut Kibernetik”, gjatë vitit 2025 është kryer vlerësimi i parë, për të pasur një pamje më horizontale dhe të unifikuar nga Banka e Shqipërisë, mbi masën e maturitetit të proceseve e kontrolleve që lidhen me rrezikun kibernetik dhe adresimin e problematikave që burojnë prej tij.

Bazuar në vlerësimin e kryer rezulton se sistemi bankar, në tërësi, tregon maturitet mesatar-të mirë, me dallime të ndjeshme ndërmjet bankave.

Nivelet e maturitetit të kontrolleve të ushtruara nga banka në lidhje me sigurinë kibernetike bazuar në grup-kontrolle janë si më poshtë:

- Kontrollet Organizative nga 40% deri 92%, një nga grup-kontrollet me luhatje të lartë sa i përket nivelit të maturitetit ku, megjithëse politikat ekzistojnë, zbatimi i tyre nuk është i njëtrajtshëm;
- Kontrollet e Personave nga 48% deri 98% – duke rezultuar në kontrolle përgjithësisht të forta në bankat me struktura të konsoliduara të burimeve njerëzore;
- Kontrollet Fizike paraqiten me maturitet nga 54% deri 93% – duke përbërë grupin më të qëndrueshëm, me përputhshmëri të kënaqshme;
- Kontrollet Teknologjike nga 39% deri 94% – ku rreziqet kryesore konsistojnë në boshllëqe në ciklin jetësor të zhvillimit të sigurt, kriptografi dhe menaxhim dobësish.

Nga vlerësimi rezulton se: ekziston një nivel bazë i zbatimit të kontrolleve të sigurisë në të gjitha bankat, ku kontrollet fizike dhe të personave paraqesin përgjithësisht nivel më të lartë maturiteti, ndërkohë që kontrollet organizative dhe teknologjike mbeten fusha me nevojë për përmirësim të mëtejshëm, me fokus të veçantë në menaxhimin e rrezikut, palët e treta dhe sigurinë e aplikacioneve.

6.4.5 Rreziku reputacional

Rreziku reputacional, si një nga rreziqet që mund të dëmtojë bankat dhe institucionet financiare në mënyrë të menjëhershme, ka si element kryesor vlerësimin mbi dyshimet e mundshme për përfshirje apo përdorim të institucioneve financiare për qëllime të pastrimit të parave dhe/ose financim të terrorizmit, mungesën e transparencës në marrëdhëniet me klientët, mosrespektimin e kushteve të punës dhe të termave të kontratave etj.

6.4.5.1 Administrimi i rrezikut të pastrimit të parave (PP) dhe financimit të terrorizmit (FT)

Rreziku i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe sanksioneve (PP/FT), përbën një nga rreziqet që mund të dëmtojë bankat dhe institucionet financiare në mënyrë të menjëhershme. Në këtë drejtim, vlerësimi fokusohet në sigurimin e një sistemi efektiv parandalues dhe ka si element kryesor vlerësimin e zbatueshmërisë të akteve ligjore dhe rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nëpërmjet monitorimit të procedurave të identifikimit të klientëve, zbatimin e vigjilencës së duhur/zgjeruar, zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit dhe të sanksioneve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025, nga inspektimet në vend të kryera në banka ka rezultuar se, për çështjet e administrimit të rrezikut të PP/FT dhe sanksioneve, bankat i kushtojnë vëmendjen e duhur dhe kanë rritur përpjekjet për një administrim të përshtatshëm të këtij rreziku, respektimin e kërkesave ligjore dhe të kuadrit të brendshëm rregullativ në këtë fushë. Përveç zhvillimeve pozitive, gjatë ekzaminimeve janë evidentuar problematika që lidhen me kuadrin rregullator, proceset e vigjilencës së duhur/zgjeruar, administrimin e rrezikut të FT, zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe trajnimet.

Në mbikëqyrjen e këtij rreziku, Banka e Shqipërisë ka vijuar bashkëpunimin me autoritetin përgjegjës, Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF). Ky bashkëpunim është shtrirë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, kryerjes së inspektimeve të përbashkëta etj. Paralelisht, ka vijuar bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme, nëpërmjet shpërndarjes të subjektet e licencuara të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave për vendosjen e sanksioneve dhe përditësimin e listës së financuesve të terrorizmit dhe të sanksioneve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025, fokusi mbikëqyrës ka vijuar të jetë në drejtim të: (i) politikave dhe procedurave të brendshme; (ii) strukturave dhe sistemeve të centralizuara; (iii) masave të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar; (iv) administrimit efektiv dhe masave kundër financimit të terrorizmit dhe zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare; (v) analizave dhe raportimit të rasteve me elemente dyshimi; (vi) trajnimeve; dhe (vii) sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Gjatë vitit 2025, janë kryer inspektime për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe janë vendosur sanksione në 38 subjekte⁹, nga këto:

- 4 banka;
- 5 subjekte financiare jobanka;

⁹ Në dy subjekte, konkretisht në një bankë dhe në një institucion të parasë elektronike, është realizuar inspektim i targetuar me fokus në drejtim të masave të administrimit të rrezikut të financimit të terrorizmit dhe sanksioneve ndërkombëtare.

- 1 subjekt IPE (institutcion i parasë elektronike), i ekzaminuar dy herë gjatë vitit;
- 1 shoqëri kursim-kreditit;
- 26 zyra këmbimi valutor (ZKV), prej të cilave në 4 ZKV është realizuar procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si rrjedhojë e mangësive të konstatuara në inspektimin e mëparshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave (PPP) dhe FT, referuar inspektimeve në vend si më lart, vlen të përmendet se janë kryer dy inspektime të përbashkëta me AIF-në, në 1 bankë dhe 1 ZKV.

Llojet e problematikave të identifikuar në banka lidhen kryesisht me kuadrin rregullator, proceset e vigjilencës së duhur/zgjeruar, që në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

- mospërfshirje të referencave ligjore në kuadrin e brendshëm rregullator;
- rishikimi i kuadrit të brendshëm në fazën e miratimit, në lidhje me afatet e monitorimit periodik;
- analiza jo të thelluara për transaksionet në vlerë të lartë që nuk lidhet me fushën e veprimtarisë së subjektit/klientit;
- numër raportimesh i ulët nga linja e parë, me përmirësim në vitin 2025, ndikuar nga masat e marra nga subjekti i mbikëqyrur.

Në lidhje me çështjet e administrimit të rrezikut të financimit të terrorizmit dhe zbatimit të sanksioneve nuk janë konstatuar problematika.

Për **institucionet financiare jobanka (IFJB)** dhe **shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK)**, nga inspektimi i tyre janë evidentuar çështje sipas tipologjive, të tilla si kuadri rregullator, proceset e vigjilencës së duhur/zgjeruar, administrimi i rrezikut FT dhe zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare, trajnimet dhe auditimi i brendshëm. Për mangësitë e evidentuara janë lënë rekomandimet përkatëse, me qëllim adresimin në kohë të tyre.

Llojet e problematikave të identifikuar në institucionet financiare jobanka (IFJB) dhe në shoqëritë e kursim-kreditit, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë kryesisht në:

kuadrin e brendshëm rregullator:

- mospërcaktimi i verifikimit të pronarit përfitues nëpërmjet regjistrit të pronarit përfitues,
- mospërcaktimi i masave sa i përket zbatimit të ligjit nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”,

- evidentimi mbi mënyrën e kryerjes së procesit të njohjes me listat e shpallura dhe të sanksioneve, si dhe për procesin e implementimit të listave të shpallura dhe sanksioneve në sistem,
- mosparashikim për raportim të menjëhershëm pranë Autoritetit Përgjegjës, për rastet kur subjekti ka dyshime për financim terrorizmi ose klienti është në listën e sanksioneve,
- mungesë e përfshirjes së bazës ligjore për masat shtrënguese ndërkombëtare,
- informacion i munguar mbi hapat e ndjekur për kontrollin e klientëve me listat e shpallura dhe të sanksioneve, masat e marra në rast dyshimi për ngjashmëri emrash me listat dhe mënyrën e përditësimit me listat e shpallura,
- mangësi në përcaktimin e profilit të rrezikut të anëtarit dhe të frekuencës së monitorimit të vazhdueshëm, në përputhje me profilin e rrezikut të anëtarit,
- mungesë përcaktimi të programit vjetor të trajnimit të personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit,
- mungesë përcaktimi të njësisë për parandalimin e pastrimit të parave;

proceset:

- mosmbajtje evidencash për verifikimet e kryera kundrejt listave për pronarët përfitues,
- mangësi të procedurës së raportimit të transaksioneve në para fizike (RTPF),
- mangësi në kryerjen e analizës për burimin e fondeve, dhe
- mangësi në masat e vigjilencës së duhur;

vlerësimin e rrezikut:

- mungesë e vlerësimit të rrezikut;

sistemin e centralizuar:

- mosevidentim në sistem të klientëve me rrezik të lartë, si dhe mungesë e kategorizimit të tyre,
- mungesë të një fushe të caktuar në sistem për profilin e rrezikut të anëtarit, dhe
- mosevidentim në sistemin e centralizuar të llojit të klientit;

stafin:

- personi përgjegjës jo në nivel administrimi,
- mangësi në njoftimin e Bankës së Shqipërisë dhe të Autoritetit Përgjegjës për emrin e personit përgjegjës;

trajnimet:

- mungesë trajnimesh për personin përgjegjës,

- mosmbajtje evidencash për trajnimet e kryera,
- trajnime të zhvilluara jo në mënyrë të vazhdueshme,
- mangësi të trajnimeve të dedikuara për zbatimin e masave shtrënguese dhe në mënyrë të veçantë për armët e shkatërrimit në masë;

çështje të tjera:

- moskryerje e *follow-up*-it nga auditimi i brendshëm,
- fokus jo i mjaftueshëm në zbatimin e detyrimeve lidhur me zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit dhe masave shtrënguese ndërkombëtare,
- mungesë e njësisë/funksionit të auditit të brendshëm,
- auditim i pamjaftueshëm i agjentëve,
- mungesë auditimi, si rrjedhojë e strukturës jo të plotë të auditimit,
- përcaktimi i përgjegjësisë ligjore për palët e treta në kontratën e nënshkruar ndërmjet subjektit dhe palëve të treta,
- kontratat me palë të treta krijojnë dyshim të arsyeshëm për kontrata fiktive;

administrimin e rrezikut FT dhe sanksioneve:

- mospërfshirje në kuadrin rregullator të bazës ligjore për masat shtrënguese ndërkombëtare,
- mosevidentim në kuadrin e brendshëm mbi mënyrën e kryerjes të procesit të njohjes me listat e shpallura dhe të sanksioneve, si dhe për procesin e implementimit të listave të shpallura dhe sanksioneve në sistem,
- mungesë e parashikimit në kuadrin rregullator për raportim të menjëhershëm pranë Autoritetit Përgjegjës, për rastet ku subjekti ka dyshime për financim terrorizmi ose klienti është në listën e sanksioneve,
- mungesë të kryerjes së vlerësimit të rrezikut,
- mungesë të përcaktimit në kuadrin rregullator të programit vjetor të trajnimit të personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit,
- mungesë të evidencave për verifikimet e kryera kundrejt listave të shpallura,
- mungesë auditimi për çështjet e FT-së dhe masave shtrënguese ndërkombëtare,
- mungesë të trajnimeve të dedikuara për zbatimin e masave shtrënguese dhe në mënyrë të veçantë për armët e shkatërrimit në masë.

Gjatë vitit 2025, Banka e Shqipërisë ka rritur ndjeshëm vëmendjen mbikëqyrëse ndaj **zyrave të këmbimit valutor**, si një sektor me ekspozim të lartë ndaj parasë fizike dhe me kontakt të drejtpërdrejtë me publikun. Për këtë arsye, fokusi i kontroleve ka qenë jo vetëm te ekzistenca e procedurave të brendshme, por sidomos te zbatimi i tyre në praktikë, përfshirë identifikimin e

klientit, monitorimin e transaksioneve, ruajtjen e dokumentacionit dhe raportimin e rasteve të dyshimta.

Në vitin 2025 janë kryer 27 inspektime në vend, kryesisht në funksion të përmbushjes së detyrave mbikëqyrëse dhe sipas rastit edhe në bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës Financiare. Gjetjet kryesore lidhen me mangësi në zbatimin e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar, mungesë të sistemeve të centralizuara për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, dobësi në dokumentimin e verifikimeve me listat e sanksioneve, mungesë trajnimesh dhe raportim jo të rregullt të veprimeve valutore pranë Bankës së Shqipërisë.

Për problematikat e konstatuara janë marrë masa mbikëqyrëse dhe administrative, si më poshtë:

Masa administrative 201 ZKV

Tërheqje vëmendjeje 1 ZKV

Revokim licence 80 ZKV

Në vijim, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë mbikëqyrjen përmes inspektimeve në vend dhe nga jashtë, me fokus te transaksionet me vlerë të lartë, veprimet e përsëritura, mospërputhjet ndërmjet profilit të klientit dhe volumit të transaksioneve, si dhe cilësia e dokumentacionit mbështetës.

6.4.5.1.1 Analiza nga jashtë

Për sa i përket analizës nga jashtë, bazuar në raportimet e kryera nga subjektet në fillim të vitit 2026, me të dhëna për vitin 2025, u realizua vlerësimi i ekspozimit të subjekteve ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vlerësimi konsiston në integrimin e dy komponentëve - sasisë së rrezikut dhe cilësisë së administrimit të rrezikut - dhe shërben si instrument për të bërë kategorizimin e institucioneve, si dhe orientimin e fokusit mbikëqyrës në funksion të parimeve të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Vlerësimi u krye për 647 subjekte financiare (11 banka, 35 IFJB, 10 SHKK dhe 591 ZKV). Rezultatet e analizës nga jashtë për subjektet financiare banka, IFJB dhe SHKK, në lidhje me sasinë e rrezikut rezultojnë 31 subjekte me rrezik të ulët, 22 subjekte me rrezik të mesëm dhe 3 subjekte me rrezik të lartë; ndërsa për vlerësimin e cilësisë së administrimit të rrezikut rezultojnë me vlerësim të kënaqshëm 34 subjekte, 14 subjekte janë me vlerësim të fortë dhe 8 subjekte me vlerësim të dobët.

Pjesë përbërëse e vlerësimit është edhe vlerësimi i integruar i transfertave të kryera nga subjektet që kryejnë veprimtarinë e transferimit të parave dhe pagesave, 46 subjekte gjithsej. Nga analiza për vlerësimin e integruar të transfertave rezultojnë me rrezik të ulët 29 subjekte, me rrezik mesatarisht të ulët 9 subjekte, me rrezik mesatarisht të lartë 3 subjekte dhe me rrezik të lartë 5 subjekte.

Për sa i përket vlerësimit të zyrave të këmbimit valutor (ZKV), në lidhje me ekspozimin ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sistemi i vlerësimit bazohet në të dhënat që ka Banka e Shqipërisë si autoritet licencues dhe mbikëqyrës i tyre dhe konsiston në vlerësimin e disa komponentëve, të tillë si: struktura aksionare, shpërndarja gjeografike, volumi i xhiros, raportimi në Bankën e Shqipërisë, struktura në rolin e nënagjentit të transferimit të parave etj. Nga vlerësimi i përgjithshëm i kryer rezultoi se 291 ZKV shfaqin nivel të lartë rreziku, 64 ZKV shfaqin nivel të mesëm rreziku dhe 236 ZKV shfaqin nivel të ulët rreziku.

6.4.5.2 Transparenca dhe publikimi i informacionit

Transparenca dhe publikimi i informacionit - elemente që ndikojnë në shkallën e besueshmërisë së publikut ndaj sistemit financiar në vend - kanë vijuar të jenë në fokusin e Bankës së Shqipërisë edhe gjatë vitit 2025.

Sjellja e bankave dhe masat e marra prej tyre në lidhje me transparencën ndaj publikut dhe publikimin e informacionit financiar janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet analizave nga jashtë dhe mbikëqyrjes në vend.

Në këtë kontekst, janë marrë në analizë detyrimet që kanë bankat për raportim në Bankën e Shqipërisë, në drejtim të zbatimit të kuadrit rregullativ për transparencën, si dhe janë evidentuar problematikat e raportimit apo publikimit në mënyrë të plotë të kushteve të punës në faqet e internetit të bankave.

Si rezultat i monitorimit dhe i masave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë është rritur ndërgjegjësimi dhe angazhimi i sektorit bankar për çështjet e transparencës dhe të publikimit të informacionit. Megjithatë, ende evidentohen çështje për përmirësim të mëtejshëm në drejtim të:

- kuadrit rregullator të brendshëm - kryesisht në drejtim të përfshirjes së kërkesave të reja rregullative, njësive përgjegjëse për publikimin e informacionit dhe raportimit në Bankën e Shqipërisë dhe trajtimit të ankesave;
- informacionit parakontraktor - në drejtim të personalizimit të informacionit dhe përfshirjes së disa prej elementeve të parashikuara në kuadrin rregullator;
- informacionit kontraktor (kontrata) të kredisë konsumatore, hipotekare, kartës së kreditit, depozitës, llogarisë rrjedhëse, llogarisë së pagesës dhe llogarisë së kursimit, në përputhje me kërkesat rregullatore;
- njoftimit të klientëve në përputhje me kërkesat rregullatore;
- elementeve të caktuara në informacionin e publikuar në faqet e internetit;
- funksionimit të llogarisë së pagesës dhe shërbimit të transferimit të llogarisë së pagesës.

Në IFJB dhe në SHKK, çështjet për t'u adresuar më së shumti lidhen me:

- politikat dhe procedurat për mospërputhje të plotë me kërkesat rregullatore;
- informacionin parakontraktor - në drejtim të përfshirjes së elementeve të parashikuara në kuadrin rregullator dhe personalizimin e saj;
- informacionin kontraktor (kontrata) të kredisë konsumatore, hipotekare, kartës së kreditit, depozitës, llogarisë rrjedhëse, llogarisë së pagesës dhe llogarisë së kursimit, në përputhje me kërkesat rregullatore;
- elemente të caktuara në informacionin e publikuar në faqet e internetit;
- publikimin e informacionit - fletëpalosjet e publikuara në ambientet e punës nuk janë të përditësuara dhe informacioni i publikuar nuk është i plotë;
- llogaritjet e normave të interesit, NEI-t, komisioneve dhe penaliteteve - metoda e llogaritjes së kështit të kredisë shoqëruar me një shembull (ilustrues).

Në kuadër të transparencës, angazhimi në inspektimet në vend ka pasur si qëllim vlerësimin e subjekteve për përputhshmërinë me kërkesat e akteve rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Përpos ekzaminimeve në vend, gjithashtu janë marrë në konsideratë: analizat në lidhje me kërkesat minimale të publikimit të raporteve financiare nga bankat dhe degët e bankave të huaja; kushtet e punës për produktet dhe shërbimet e ofruara nga bankat dhe subjektet financiare jobanka; si dhe materialet publicitare të përdorura nga bankat dhe subjektet financiare jobanka, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e reja rregullatore të Bankës së Shqipërisë mbi reklamat e produkteve dhe shërbimeve bankare e financiare, me fokus mbrojtjen e konsumatorit dhe shmangien e praktikave potencialisht çorientuese.

Në kuadër të informimit të publikut është realizuar në mënyrë periodike publikimi i formularëve të transparencës mbi normat e interesit dhe komisionet për produktet dhe shërbimet e ofruara për publikun nga bankat dhe IFJB-të.

Gjatë vitit 2025, Zyra për Mbikëqyrjen e Rrezikut Reputacional ka kontribuar aktivisht si anëtare të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 28 “Mbrotjtja e Konsumatorit dhe Shëndetit”, në kuadër të procesit të integritimit evropian.

6.4.5.3 Trajtimi i ankesave

Trajtimi i ankesave nga klientët ka zënë një peshë të konsiderueshme në kuadrin e transparencës dhe mbrojtjes së klientëve të sektorit financiar. Në vitin 2025, numri i ankesave të trajtuara nga Zyra për Mbikëqyrjen e Rrezikut Reputacional ka shfaqur një rritje të ndjeshme, ku është shënuar niveli më i lartë historik, me 493 ankesa, duke reflektuar kështu rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, kompleksitetin në rritje të produkteve financiare dhe intensifikimin e fokusit institucional mbi mbrojtjen e konsumatorit.

Përveç sa është trajtuar më sipër, gjatë vitit 2025, janë trajtuar 145 ankesa të mbërritura nga individë për ish-IFJB-të “Micro Credit Albania” dhe “Final”.


Grafik 17. Numri i ankesave të trajtuara në vite



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç shihet edhe në Grafikon 18, numrin më të madh të ankesave të trajtuara e zënë individët me 83.77% të tyre.


Grafik 18. Pësja e ankesave sipas segmentimit të ankuesve



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Siç vërehet nga Grafiku 19, peshën më të madhe e zë produkti i kredisë konsumatore me 26%.

Grafik 19. Pësja e ankesave sipas segmentimit të produkteve të reklamuar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Pesha e ankesave sipas tipologjisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Siç vërehet nga Grafiku 20, peshën më të madhe e zë tipologjia “Kërkesë për informacion nga Banka e Shqipërisë” me 19%.

6.4.6 Përfitueshmëria

6.4.6.1 Rezultati neto dhe struktura e tij

Rezultati financiar i sistemit në fund të vitit 2025 shënon nivelin 35.6 mld lekë, në rënie me rreth 1 miliardë apo 2.9% më pak se viti 2024. Krahësuar me një vit më parë, sistemi bankar ka bërë një performancë më të mirë sa i përket aktivitetit të tij kryesor si dhe aktiviteteve të tjera, ndërkohë që ka pësuar më pak kosto risku (alokuar më pak shpenzime për provigjone). Megjithatë rezultati financiar neto ka ardhur në rënie, për shkak të rritjes së shpenzimeve të veprimtarisë me 5.6 miliardë lekë ose 12.9%, të cilat nuk mundën të mbulojnë të ardhurat shtesë, si pasojë e zhvillimeve pozitive të sipërpërmendura.

Gjatë vitit 2025, evidentohet një rritje e rezultatit financiar neto në të gjithë tremujorët. Rritja më e madhe evidentohet në tremujorin e dytë dhe të katërt me rreth 9.3 mld lekë, pasuar nga tremujori i tretë me 8.3 mld lekë.

6.4.6.2 Treguesit e përfitueshmërisë

Ecuria e treguesve kryesorë të përfitueshmërisë, përkatësisht kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) dhe kthimi nga kapitali aksionar mesatar (RoAE), rezultojnë në rënie krahasuar me vitin 2024. Në fund të vitit 2025, vlerat e regjistruara rezultojnë përkatësisht 1.64% për RoAA dhe 15.9% për RoAE, ndërkohë që në fund të vitit 2024 këta tregues ishin përkatësisht 1.82% dhe 17.9%.

Tabelë 14. Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë (në përqindje; kumulative)

Treguesit	Dhjetor 2025	Dhjetor 2024	Dhjetor 2023	Dhjetor 2022
RoAA	1.64	1.82	1.69	1.19
RoAE	15.9	17.9	17.0	11.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabela në vijim shfaq përfitueshmërinë e sistemit bankar nga veprimtaria kryesore, si dhe dinamikën e ekuilibrit ndërmjet mbledhjes së burimeve për të cilat paguhet interes dhe investimit në aktive që gjenerojnë të ardhura. Dinamika e tyre gjatë vitit 2025 tregon për një rënie të lehtë të eficiencës së përdorimit të burimeve me 0.2 pikë përqindje, e ndikuar nga rënia e të ardhurave nga interesat në krahasim me rritjen minimale të shpenzimeve për interesa.

Tabelë 15. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore (në përqindje; kumulative)

	Dhjetor 2025	Dhjetor 2024	Dhjetor 2023	Dhjetor 2022
Të ardhurat nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura(1)	4.49	4.7	4.5	3.5
Shpenzime për interesa/aktive mesatare që sjellin të ardhura(2)	1.11	1.1	0.9	0.7
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) - (2)]	3.4	3.6	3.6	2.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2025, raporti i aktiveve mesatare që sjellin të ardhura ndaj aktiveve mesatare u rrit me 0.73 pikë përqindjeje (nga 87.78 % në 88.51%) krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndikuar nga rritja më e madhe e aktiveve mesatare që sjellin të ardhura përkundrejt rritjes së aktiveve mesatare. Për sa i përket raportit ndërmjet pasiveve mesatare që shkaktojnë shpenzime kundrejt aktiveve mesatare, rezulton se ky raport është rritur me 0.57 pikë përqindjeje (nga 86.34% në 86.91%) në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes më të shpejtë të pasiveve që gjenerojnë shpenzime krahasuar me aktivet mesatare.

Tabelë 16. Treguesit mesatarë të përfitueshmërisë (në milionë lekë)

Treguesit	Dhjetor 2025	Qershor 2025	Dhjetor 2024	Qershor 2024
Aktivitet mesatare që sjellin të ardhura (1)	1,922,346.3	1,879,921.0	1,755,267.8	1,716,243.3
Pasivitet mesatare që shkaktojnë shpenzime (2)	1,887,534.3	1,837,293.5	1,738,308.2	1,705,489.5
Aktivitet mesatare (3)	2,171,909.6	2,125,302.8	2,013,426.2	1,981,447.4
(1) / (3)	88.51%	88.45%	87.18%	86.62%
(2) / (3)	86.91%	86.45%	86.34%	86.07%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i efikasitetit të përdorimit të burimeve nga sistemi ka pësuar një rënie të konsiderueshme me 17.73 p.p. në krahasim me vitin pararendës, në kushtet kur shpenzimet operacionale janë rritur me ritme më të larta se të ardhurat operacionale. Konkretisht, të ardhurat operacionale janë rritur me rreth 0.7 miliardë lekë ose 0.93%, ndërkohë që shpenzimet operacionale janë rritur me rreth 5.6 miliardë lekë ose 12.9%.

Tabelë 17. Ecuria e treguesit të efikasitetit (në milionë lekë)

Treguesit	Dhjetor 2025	Dhjetor 2024	Dhjetor 2023	Dhjetor 2022
Rezultati neto nga interesat (1)	73,485.7	72,810.3	67,386.1	48,707.8
Shpenzimet e veprimtarisë (2)	49,095.1	43,491.3	40,910.9	33,866.5
Efikasiteti (1) / (2)	149.68%	167.41%	164.71%	143.82%

Burimi: Banka e Shqipërisë.


6.4.7 Mjaftueshmëria e kapitalit

6.4.7.1 Kapitali aksionar

Në fund të vitit 2025, kapitali aksionar i sistemit bankar arriti në nivelin e 235.65 miliardë lekësh, me një rritje vjetore prej 21.08 miliardë lekësh ose 9.8%.

Gjatë vitit 2025, rritja e kapitalit aksionar gjatë tremujorëve është luhatur midis normave 1.5% dhe 3.9%.

Grafik 21. Ecuria e kapitalit aksionar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Komponentët me ndikim më të madh material në rritjen e kapitalit aksionar janë rritja e fitimeve të pashpërndara me 13.1 miliardë lekë ose 30.1%, si dhe rritja e rezervave me 3.3 miliardë lekë ose 9%.

Tabelë 18. Struktura e kapitalit aksionar të sistemit dhe ecuria e komponentëve të tij

Treguesit	Dhjetor 2025		Dhjetor 2024		Dhjetor 2023		Dhjetor 2022	
	mIn lek	%	mIn lek	%	mIn lek	%	mIn lek	%
Kapitali aksionar	235,651.5	100.0	214,571.2	100.0	194,804.0	100.0	183,384.3	100.0
Kapitali i paguar	114,828.7	48.7	105,090.5	49.0	97,840.3	50.2	94,421.6	74.8
Primet e aksioneve	8,607.5	3.7	7,713.9	3.6	7,152.7	3.7	7,152.7	4.4
Rezervat	39,938.6	16.9	36,627.8	17.1	35,626.4	18.3	34,140.2	12.4
Diferencë rivlerësimi	(19,732.0)	(8.4)	(14,876.9)	(6.9)	(14,888.9)	(7.6)	(8,386.7)	(4.7)
Fitim/humbje e pashpërndarë	56,409.2	23.9	43,346.0	20.2	37,176.4	19.1	35,267.6	0.8
Fitim/humbje e periudhës	35,599.5	15.1	36,669.9	17.1	31,897.1	16.4	20,788.8	12.5


Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.4.7.2 Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Përkundrejt minimumit rregullator të kërkuar prej 12%¹⁰, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, si tregues thelbësor mbikëqyrës, në fund të vitit 2025, raportohet në nivelin 20.36%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ky tregues shfaqet me një rritje prej 0.14 pikësh përqindjeje.

¹⁰ Për disa banka, ky nivel është kërkuar më i lartë se minimumi rregullator.

Grafik 22. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe komponentëve të saj



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.4.7.2.1 Kapitali rregullator

Kapitali rregullator i sistemit bankar evidentohet në nivelin 232.20 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2024, kapitali rregullator shfaq një rritje prej 20.78 miliardë lekësh ose 9.83%.

Raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik është rritur lehtë në 20.36%, nga 20.22% në vitin 2024. Kapitali bazë i sistemit bankar përbën komponentin kryesor të kapitalit rregullator të sistemit. Ky tregues qëndron në nivele të larta, çka tregon për një kapital rregullator cilësor të qëndrueshëm.

6.4.7.2.2 Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik

Totali i aktiveve dhe i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik është rritur në krahasim me vitin e kaluar me rreth 94.5 miliardë lekë ose 9%. Elementi që ka peshën më të madhe në totalin e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezik janë aktivet për të cilat kërkohet kapital për rrezikun e kredisë, me 83.82%, i ndjekur nga aktivet për të cilat kërkohet kapital për rrezikun operacional, në nivelin 14.46%, si dhe nga aktivet për të cilat kërkohet kapital për rrezikun e tregut, me 1.72%.

6.5 Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit

6.5.1 Subjektet financiare jobanka

6.5.1.1 Të përgjithshme

Në fund të vitit 2025, sistemi financiar numëron 22 subjekte financiare jobanka. Përgjatë këtij viti nuk ka pasur licencime të reja. Në dhjetor 2025, u revokua licenca e subjektit “Lendal” sh.p.k., ndërsa subjekti NOA u përthith nga Banka Amerikane e Investimeve. Informacioni mbi veprimtarinë e subjekteve paraqitet në mënyrë të përmblodhur në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 19. Veprimtaritë e lejuara për subjektet financiare jobanka

Nr.	Institucion e Financiare Jobanka	Para elektronike	Shërbime të pagesave dhe transferimit të parave	Veprimtari me Rrezik Kredie							Këmbim valutor	
				Kredidhënie	Mikrokredi	Qira Financiare	Faktoring	Shërbimet këshilluese ndërmjetës e dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë e kredise	Për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve	Blerje Kredi me probleme	Shërbime të këmbimit valutor	Shërbime këshilluese për këmbimin valutor
1	Agro & Social Fund (VF)				✓							
2	Kredit Partner				✓							
3	Agrokredit - ish FAF			✓				✓	✓			
4	Ak-Invest		✓	✓			✓	✓	✓		✓	✓
5	Albania Leasing					✓						
6	Albanian Financial Institution			✓		✓	✓	✓	✓			
7	Crimson Finance Fund Albania (C			✓		✓	✓	✓				
8	Fondi Besa			✓				✓	✓			
9	Iutecredit Albania				✓							
10	ECFA				✓							
11	Landeslease					✓						
12	MiA Finance				✓							
13	Credital				✓							
14	Virtus Lending					✓						
15	FAB INVEST shpk			✓			✓	✓				
16	Porsche Leasing					✓						
17	Raiffeisen Leasing					✓						
18	Tirana Capital Trade						✓					
19	Tirana Factoring & Lease					✓	✓				✓	
20	Tranzit			✓		✓	✓	✓				
21	Antigone Financial Enterprise					✓						
22	New collection									✓		

Burimi : Banka e Shqipërisë.

6.5.1.2 Aktiviteti i IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit (të gjitha format e kredidhënies, mikrokredi, qira financiare, faktoring dhe blerje kredish me probleme)

Totali i aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit gjatë vitit 2025 ka njohur rënie me rreth 9.11 miliardë lekë ose 12% për shkak se një nga subjektet me peshë të lartë në këtë segment (NOA – 22%), është përthithur nga një bankë e nivelit të dytë. Kjo ka sjellë luhatje në ecurinë e të gjithë treguesve të sektorit të IFJB-ve. Në dhjetor 2025, aktivet e këtyre subjekteve arrinin në 66 miliardë lekë, duke përbërë 2.8% të totalit të aktiveve të sistemit bankar.

Subjektet me peshën më të lartë në totalin e aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit janë: “Fondi Besa” (34%), “Iutecredit Albania” (16%) dhe “Raiffeisen Leasing” (9%).



Tabelë 20. Totali i aktiveve të IFJB-ve

Treguesi/miliardë lekë	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025
Totali i aktiveve të IFJB-ve	64.65	74.72 ¹¹	65.60

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në strukturën e aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit, peshën kryesore e mban portofoli i kredisë me 72%. Pjesa tjetër është e shpërndarë në aktive likuide (12%), të tjera të arkëtueshme (7%), dhe mjete të tjera (përfshirë mjetet e qëndrueshme) (4%).

Grafik 23. Shpërndarja e aktiveve të IFJB-ve, dhjetor 2025 Grafik 24. Shpërndarja e burimeve të financimit të IFJB-ve, dhjetor 2025



Burimi: Departamenti i Statistikave dhe përpunime të stafit të Departamentit të Mbikëqyrjes.

¹¹ Totali i aktiveve për vitin 2024 është rishikuar për shkak se një nga subjektet financiare jobanka ka riaudituar të dhënat financiare.

Burimet parësore të financimit për IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit janë huamarrjet (67% e pasivit) dhe kapitali i tyre (29%). Huamarrja përmes emetimit të titujve zë vetëm 1.2%. Për sa i përket origjinës së huamarrjeve, balanca anon lehtë nga jorezidentët me 51%.

6.5.1.2.1 Zhvillimet në tepricën e portofolit të kredisë dhe vëllimet e veprimtarisë

Në fund të vitit 2025, portofoli i kredisë bruto për IFJB-të arrin në 53.19 miliardë lekë, duke njohur një rënie prej 5.48¹² miliardë lekësh (ose 9%) krahasuar me vitin paraardhës. Portofoli i kredisë bruto të IFJB-ve arrin në 5.34% të totalit të kredisë së sistemit bankar, duke regjistruar një rënie prej 1.33 p.p. krahasuar me vitin paraardhës.

Tabelë 21. Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e IFJB-ve

Treguesi/miliardë lekë	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (bruto)	53.61	58.68	53.19
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (neto)	47.15	52.69	47.30

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së IFJB-ve mbahet nga subjektet e kredidhënies dhe mikrokredisë (73%). Më pas renditet portofoli i qirasë financiare (26%), ndërkohë që pesha e portofolit faktoring mbetet në 1%.

Aktiviteti me rritjen më të lartë gjatë vitit 2025 ka qenë qiraja financiare, me 1.52 miliardë lekë. Efektin kryesor në rritjen e këtij portofoli e kanë dhënë subjektet “Porsche Leasing” dhe “Raiffeisen Leasing”. Pas largimit të subjektit “NOA”, aktiviteti i kredidhënies dominohet nga “Fondi Besa”. Ndërkohë, sa i përket aktivitetit të mikrokredisë, subjekti “Iutecredit” vijon të shfaqë rritjen më të lartë të portofolit të mikrokredisë.

Tabelë 22. Ecuria e portofolit të kredisë bruto sipas veprimtarive të IFJB-ve

Veprimtaritë financiare (në miliardë lekë)	Dhjetor 2023	Dhjetor 2024	Dhjetor 2025
Kredidhënie	18.8	21.7	15.6
Mikrokredi	23.2	24.1	23.0
Qira financiare	11.2	12.5	14.1
Faktoring	0.4	0.4	0.6
Portofoli bruto	53.6	58.7	53.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2025, portofoli i financimeve të subjekteve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit është i orientuar drejt individëve me 57%, ndërsa ndaj bizneseve me 43%.

¹² Revokimi i licencës së subjektit NOA ka ndikuar në rënien e totalit të portofolit të kredive të IFJB-ve.

Sektorët e ekonomisë më të financuar nga subjektet jobanka gjatë vitit 2025 kanë qenë “Tregtia, riparimi i automjeteve” (18%), “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” (10%) dhe “Bujqësia, Pyjet, Peshkimi (10%).

Portofoli i IFJB-ve mbetet i orientuar drejt financimeve në monedhën vendase (66%) dhe me afat të mesëm maturimi (73%).

Portofoli i qirasë financiare, sipas produkteve, dominohet nga financimet për mjete transporti personale (67%) dhe mjete transporti pune (24%). Krahasuar me dhjetorin 2024, portofoli shënon një rritje me rreth 1.52 miliardë lekë, e përqendruar tek produkti “Mjete transporti personale”.

Tabelë 23. Portofoli i qirasë financiare sipas objektit të financuar

Qira Financiare (miliardë lekë)	Pajisje e re	Pajisje e përdorur	Dhjetor 2024	Pajisje e re	Pajisje e përdorur	Dhjetor 2025
Mjete transporti personale	2.38	2.82	5.20	5.92	3.48	9.40
Mjete transporti pune	2.38	1.13	3.5	2.50	0.93	3.42
Pajisje pune/linja prodhimi	0.61	0.18	0.79	0.77	0.19	0.96
Pasuri të patundshme	0.11	0.08	0.19	0.02	0.15	0.17
Të tjera	2.8	0.05	2.85	0.10	0.00	0.10
